بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ



Imam Sejid Ali Khamenei

ÇELËSI I MIRËSISË

Fragmente nga mendimi i Imam Khameneit
(Allahu i dhëntë jetë të gjatë!),
rreth asketizmit dhe qëndrimit larg dynjasë

Tiranë, 2021

Titulli i librit: Çelësi i mirësisë

Autori: **Imam Sejid Ali Khamenei**

Përktheu: **Vullnet Merja**

Redaktoi: **Jerida Kulla**

Korrektoi: **Vjollca Karaj**

Përgatiti për shtyp & Kopertina:**Sabrie Feza**

Botues: **Shoqata FLLADI**

Transmetohet se Ebu Abdullahu, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!),* ka thënë: *"E gjithë mirësia ndodhet në shtëpi dhe çelësi i saj (mirësisë) është asketizmi në këtë botë"*.

I Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë*: "Njeriu nuk ka për ta gjetur ëmbëlsinë e besimit në zemrën e tij, derisa të asketojë në këtë botë"*.

Ebu Abdullahu, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, ka thënë: *"Ëmbëlsia e besimit është e ndaluar për zemrat tuaja, derisa të asketoni në këtë botë"*.[1]

[1] "El Kafij", vëll. 2, K. "Dhemmu dunja ue ez zuhdu fijha", Hadithi 2, f. 128.

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve! Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi zotërinë tonë, Profetin Muhamed dhe mbi familjen e tij të pastër dhe të dëlirë.

"Adhurimi më i mirë që i bëhet Allahut, është asketizmi në këtë botë".[2]

"Shenja dalluese e atij që kërkon shpërblimin e Ahiretit (Botës Tjetër), është asketizmi në lulen e kësaj bote".[3]

"E gjithë mirësia ndodhet në shtëpinë time, çelësi i saj është asketizmi në këtë botë".[4]

Këto dhe udhëzime të tjera, kanë ardhur nga Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe nga imamët e pagabueshëm *(Paqja qoftë mbi ta!)*, të cilët i kanë paralajmëruar njerëzit mbi rrezikun e rënies së tyre në robërinë e kësaj bote. Ajo që ne shohim në biografinë e Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)*, është shembull i shkëlqyer i asketizmit të vërtetë, shoqëruar me punën dhe përpjekjen e palodhur për ta rindërtuar këtë botë dhe për t'u shërbyer

[2] El Mirza En Nurij, "Mustedrekul Uesail", vëll. 12, K. "Ez zuhdu fi dynja uahdehu", Hadithi 25, f. 50.
[3] Esh Shejkh El Kulejni në "El Kafij", vëll. 2, K. "Dhemud dunja ue ez zuhdu fijha", Hadithi 6, f. 129.
[4] "El Kafij", vëll. 2, f. 128.

robve të Zotit (njerëzve), duke pasur për qëllim largimin nga zbukurimet dhe kënaqësitë e kësaj bote.

Një nga intrigat më të rrezikshme, që i mundojnë sot njerëzit e punës dhe të sakrificës, është se ata synojnë bashkimin e dynjasë dhe të Ahiretit, për hir të kësaj bote. Për këtë na paralajmëron jetëshkrimi i Imamëve tanë.

Asketizmi është në asimetri me dashurinë për dynjanë. Kjo dashuri që përbën një spirale të rrezikshme, është origjina e të gjitha gjynaheve, mëkateve dhe largimeve nga Rruga e Drejtë.

Thuhet se "*dashuria për botën, është koka e çdo gjynahu*".[5]

Asketizmi i vërtetë, jo vetëm i shpëton besimtarët nga kjo dashuri, por edhe i mbron ata nga zhytja në llumin e kësaj bote (dynjaje) të lirë e të pavlerë.

Kështu ishte dhe është jeta e udhëheqësve muxhahidinë, si: Imam Khomejni *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, Imam Khamenei *(Allahu i dhëntë jetë të gjatë!)*, Sejid Abas El Musauij *(Allahu e mëshiroftë!)* e të tjerë udhëheqës e dëshmorë. Ata janë shembuj të ndritshëm, që na kujtojnë asketizmin e Imamëve tanë *(Paqja qoftë mbi ta!)*. Ata janë shembujt tanë.

[5] "El Kafij", vëll. 2, f. 131.

Rruga e lavdisë, e fitores dhe e kënaqësisë së Allahut të Madhëruar është largimi nga zbukurimet dhe luksi i kësaj bote dhe të qenit të kënaqur me jetën e thjeshtë.

Imam Khamenei *(Allahu ia shtoftë jetën!)*, me vizionin e tij të mprehtë, vëren ngjarjet e historisë që zhvillohen para tij. Kur ai ligjëronte para shokëve të tij, i këshillonte ata me butësi. U shpjegonte biografinë e atyre që mbështetën Imamin e tyre, por që më pas u bënë pengesë për të në momentet më vendimtare, kur dynjaja u shtrua para tyre dhe ata u dhanë pas saj, duke u bërë prej kërkuesve të saj. Rezultatet ishin të dhimbshme dhe shenjat ishin të dukshme, deri në ditën e fundit të jetës së tyre.

Sot, shoqëria duhet të ftohet në asketizëm, që nga njerëzit e veçantë deri te njerëzit e zakonshëm.

Vëllezër të dashur! Në duart tuaja keni një buqetë të zgjedhur me fjalët e Imam Khameneit *(Allahu ia shtoftë jetën!)*. Në të tregohet qartë ndjeshmëria që tregon udhëheqësi i urtë rreth vesveseve të rrezikshme të kësaj bote dhe shqetësimin e tij për rininë dhe popullin e tij në fushën e sprovës së madhe.

Janë fjalë tërheqëse dhe të sinqerta. Me elokuencë të qartë, ai rrëfen ngjarje nga historia. Jep këshilla dhe udhëzime, ku tregohet kujdesi dhe shqetësimi për banorët e vendit të tij. Këtë e bën, me qëllim që të mos përsëritet historia dhe të kthehen në të shkuarën.

Duke u bazuar në ajetin e Kur'anit Fisnik: **"Në të Dërguarin e Allahut është shembulli më i mirë"**, mendojmë se ia vlen t'i referohemi në fillim asketizmit të të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!),* i përcjellë nga gjuha e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Ligjërimin e tij, plot mësime e këshilla, e vendosëm si hyrje të këtij libri, duke e lutur Allahun e Madhëruar që të ndjekim shembullin e tij.

Shoqata "Flladi"

Hyrje

Aspekte nga jeta e Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!),* të transmetuara nga Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*

"Ndiqe Profetin tënd më të mirë dhe më të pastër. Tek ai gjejmë shembullin më të mirë për këdo që do të marrë shembull; krenarinë më të lartë për këdo që do të krenohet. Njeriu më i dashur tek Allahu është ai që merr shembull të Dërguarin e Tij dhe ecën në gjurmët e tij.

Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) iu afrua e gjithë dynjaja të hante në të, por nuk hëngri asgjë prej saj. Qëndroi më i urituri i njerëzve në dynja. Stomaku i tij nuk u ngop asnjëherë. Iu ofrua e gjithë bota, por nuk e pranoi atë. Ai e dinte se çfarë urrente Allahu i Madhëruar dhe e urreu atë, e përbuzi çfarë përbuzte Zoti i Lartësuar dhe e nënvlerësoi atë që Zoti i Plotfuqishëm e nënvlerësoi.

Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!), ushqehej në tokë, qëndronte ulur si një njeri i zakonshëm, i qepte vete sandalet e tij, i arnonte vetë rrobat e tij, hipte në gomar, si dhe merrte me vete, në kafshën e tij, bashkudhëtarë.

Një perde e zbukuruar, e vendosur në derën e shtëpisë së Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!), bëri që ai të thërriste një prej grave të tij: "O filane, largoje atë prej andej. Kur e shoh atë, kujtoj dynjanë dhe zbukurimet e saj".

E kundërshtoi dynjanë me zemrën e tij. Nuk e përmendi në vetvete. Dëshironte ta largonte bukurinë e saj nga sytë e tij, për të mos e marrë si zbukurim, duke mos e besuar atë si një urdhër dhe duke mos pretenduar asnjë pozitë në të. E nxori atë nga shpirti i tij dhe e largoi nga zemra. E fshiu nga shikimi. Ai që e urren një gjë, është i neveritur prej saj dhe nuk dëshiron ta shikojë atë, si dhe nuk do të përmendet në praninë e tij.

Tek i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!) mund të gjesh udhëzuesin mbi mangësitë e dynjasë dhe problematikat e saj. Ai jetoi i uritur në këtë botë me të përzgjedhurit e tij, edhe pse iu ofrua dynjaja me bukuritë e saj, ashtu sikurse ai gëzonte pozitën e lartë tek Allahu i Madhëruar.

Çdokush mund të logjikojë me mendjen e tij: A e lartësoi Allahu i Madhëruar Muhamedin apo e poshtëroi atë? Në qoftë se e poshtëroi, atëherë ai ka gënjyer dhe ka shpifur për Allahun e Madhëruar. Në qoftë se thotë se e ka lartësuar, atëherë duhet ta dijë se Allahu i Madhëruar i ka poshtëruar të tjerët që u shtroi dynjanë dhe ata ranë pre e saj. Merr shembull nga i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!), ndiqi gjurmët e tij, pasoje Sunetin e tij. Në të kundërt, nuk je i mbrojtur nga humbja. Allahu i Madhëruar e bëri Muhamedin (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!), argument

për Kiametin, përgëzues për Xhenetin, paralajmërues për ndëshkimin. U largua nga kjo botë i uritur. U përcoll në Ahiret i panjollosur. Nuk la gur mbi gur, derisa e arriti qëllimin e tij dhe iu përgjigj thirrjes së Zotit të tij.

Allahu i Madhëruar na ka dhuruar mirësi të madhe, kur na begatoi me paraardhës dhe udhëheqës të tillë, që të ecim në rrugën e tyre. Pasha Allahun, unë e arnova veshjen time të leshtë, derisa pata turp prej arnave të saj. Dikush më pyeti: "A nuk po e hedh (flak) atë?"

Iu përgjigja: "Largohu prej meje!"

Në mëngjes herët falënderohen njerëzit që kanë ecur natën."

Një fjalë e urtë thotë: "Në mëngjes herët falënderohen njerëzit që kanë ecur natën". Kuptimi i kësaj fjale të urtë, është: Kur të zgjohen nga gjumi ata që flenë dhe të shohin ata që kanë ecur natën, që i kanë arritur qëllimet e tyre dhe falënderojnë ecjen që bënë natën, gjumashët do të pendohen për gjumin e tyre.

Kur zbardh agimi dhe udhëtarët e natës kanë arritur qëllimin për të cilin kanë ecur, janë falënderues për ecjen e tyre, edhe pse udhëtimi ka qenë i vështirë.

Qëllimi nga ky shembull është: E ardhmja dhe pararoja është për njerëzit, që t'i përmbahen të drejtës.

KAPITULLI I PARË

PERIUDHA JONË NDËRMJET ASKETIZMIT DHE UDHËTIMIT NË DYNJA

Sqarim dhe qartësim

Transmetohet nga Ebu Abdullah Es Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* se, kur Allahu i Madhëruar bisedoi me Musain *(Paqja qoftë mbi të!),* i tha: "O Musa, mos rend pas kësaj bote, ashtu siç rendin zullumqarët. Mos e duaj këtë botë si dashuria për nënën dhe babanë. O Musa, nëse dëshiron të mbështetesh në këtë botë, atëherë dashuria për dynjanë dhe bukurinë e saj ka triumfuar në zemrën tënde.

O Musa, garo me vepërmirët dhe kaloi ata në punë të mira. Mirësia është si emri i saj. Largohu nga pasuria e kësaj bote. Sytë e tu nuk duhet të shikojnë këdo që është i dashuruar me këtë botë, si dhe i beson vetvetes. Çdo sprovë fillon me dashurinë për këtë dynja. Mos u bëj xheloz për askënd për pasurinë e bollshme, sepse me shtimin e pasurisë shtohen gjynahet kundrejt detyrimeve. Mos i jepni askujt kënaqësinë tuaj, derisa të dini se Zoti është i kënaqur me të. Mos u tundo nga bindja e njerëzve ndaj krijesës, sepse bindja dhe pasimi i njerëzve ndaj tij, në rrugë jo të drejtë, është shkatërrim për të dhe pasuesit e tij".

O Musa, mos rend pas kësaj bote, ashtu siç rendin zullumqarët!

Qëllimi i thirrjes së me togfjalëshin "rendje pas kësaj bote", është të tregojë animin (dëshirën) e zemrës drejt saj, ose besimin shpirtëror në të. Nëse ne dëshirojmë ta shprehim në gjuhën tonë bashkëkohore, mund të themi si lidhja e zemrës me dynjanë. Pra, qëllimi i këtij togfjalëshi është "mos e lidh zemrën pas kësaj bote, ashtu siç i kanë lidhur zullumqarët zemrat e tyre me dynjanë". Nëse njeriu nuk do të lidhej me dynjanë, atëherë nuk do të bënte padrejtësi. Kur njeriu i dëmton robtë e Allahut, duhet ta dijë se padrejtësia e ka burimin nga lidhja e tij me dynjanë dhe dëshira e tij për të.

Mos e duaj këtë botë, ashtu si do nënën dhe babanë

Kjo do të thotë se të gjitha mendimet e tij të lidhen me dynjanë. Nuk mendon për asgjë tjetër veç saj. Ai nuk shfaq dëshira të tjera vetëm se për dynjanë. Ajo është puna me të cilën merret. Ashtu si fëmija që qëndron pranë nënës dhe babait të tij, ai është i lidhur me ta, si dhe nuk mendon për asgjë tjetër veç atyre të dyve.

O Musa, nëse dëshiron të mbështetesh në këtë botë, atëherë dashuria për dynjanë dhe bukurinë e saj ka triumfuar në zemrën tënde

Folja "ta shohësh", ndryshon nga togfjalëshi "të shohësh për atë", sepse shikimi i dynjasë nuk është gjynah, por ajo që është gjynah, është kur thua "shikimi për dynjanë", që do të thotë të mendosh për dynjanë dhe të merresh me të.

Këtu dëshiroj t'i referohem një pike, e cila është: "Ajo që nënkuptohet me fjalën "dynja", jo vetëm në këtë hadith, por edhe në hadithe të ngjashme me të, nuk nënkupton tokën dhe çfarë lidhet me të, as ndërtimet në të, ose shqetësimi me punët e çështjet e njerëzve, si dhe as punë e vepra të tjera të këtij lloji. Ajo që kemi për qëllim dhe nënkuptohet, janë aspektet e kësaj bote (të tilla, si: paratë, prestigji dhe pozita) që një person dëshiron për vete. Prandaj, të gjitha mirësitë e Allahut, që ekzistojnë në faqen e tokës, si dhe mirësitë, bizhuteritë, kënaqësitë e kështu me radhë, që kërkon dhe dëshiron njeriu për veten e tij, janë ato që shprehin transmetimet dhe hadithet me termin "dynja, kjo botë". Kjo është e qortueshme.

Është e qartë se një person, sa më shumë të mendojë për dynjanë dhe shqetësohet për të, aq më shumë e dëshiron dhe përmallohet për të. Sa herë që ai largohet prej saj, dashuria për dynjanë largohet gradualisht nga zemra e tij.

Qëllimi ynë nga ky transmetim e të ngjashëm me të, nuk është që njeriu të ndalojë interesin për punën dhe aktivitetin e tij dhe të ulet e të qëndrojë në cep të shtëpisë së tij, ashtu siç e kanë përfytyruar disa njerëz kuptimin e transmetimit për vite dhe shekuj me radhë, kështu që ata ndoqën një qasje të gabuar, duke zgjedhur izolimin dhe qëndrimin larg jetës, fushave të punës, veprimtarisë dhe përpjekjeve, duke bërë përputhjen ndërmjet këtij gabimi dhe këndvështrimit islam. Prandaj, kuptimi i fjalës "dynja" nuk është kuptim i gabuar.

O Musa, garo me vepërmirët dhe kaloi ata në punë të mira. Mirësia është si emri i saj.

Konkurrenca është dëshirë e përzier me garim. Ajo shfaqet te një person për një punë a vepër. Kuptimi i fjalës "mirësi" është i bukur dhe i lavdërueshëm. Duket se ajo që nënkuptohet me mirësi, janë pikërisht ato vepra të mira, me natyrë të përgjithshme, sikurse janë mirësia ndaj besimtarëve, ndihma e vëllezërve, bashkimi dhe bashkëpunimi, adhurimi i Zotit të Madhëruar, asketizmi në këtë botë dhe cilësi të tjera, të mira.

Fjala "mirësi", gjithashtu, nënkupton edhe kryerjen e veprave të mira. Ajo është tregues i më të mirës. Pra, kuptimi i hadithit është: Veprat e mira janë si emri i tyre. Ato janë më të mira se çdo gjë tjetër. Veprat e mira që kryen një njeri, janë më të mira se gjithçka që i vjen në mendje.

P.sh, vizita e të sëmurit, mirësia ndaj vëllait besimtar, bashkëpunimi, kërkimi i dijes, largimi nga dynjaja dhe bukuritë e saj, sakrifica në Rrugën e Zotit dhe adhurimi i Tij, të Madhëruarit dhe të Lartësuarit, urdhërimi në të mirë dhe ndalimi i të keqes. Të gjitha këto vepra janë veprime mirësie. Ato janë më të mira se çdo gjë tjetër që mund t'i shkojë në mendje një njeriu, të tilla, si: paratë, fëmijët, prestigji, pozita e të tjera të ngjashme me to që i përkasin gjërave materiale dhe çështjeve të kësaj bote.

Dijetari i ndier, El Mexhlisij, për shpjegimin e këtij hadithi, ka përmendur disa variante, në librin "Tuheful Ukul". Një prej tyre është kuptimi që i jemi referuar. Ekzistojnë një sërë mundësish, por duket se kjo mundësi është më e sakta.

Nga pasuria e kësaj bote, largo atë që nuk të nevojitet

Kjo do të thotë që, largohu nga gjithçka që nuk të nevojitet nga çështjet e kësaj bote, ose që nuk është në mesin e nevojave të tua dhe është e tepërt në të.

Mos e shiko atë që të sprovon në këtë botë

Duhet të theksohet se kjo frazë mund të lexohet në shumë mënyra: Sytë e tu nuk shohin. Në këtë fjali, fjala "sytë" është subjekti i veprimit "shohin". Ajo që nënkuptohet në këtë fjali, është: Pengojini sytë tuaj të shikojnë; Të mos shohin sytë e tu. Pra, ajo që ka për qëllim, është: Largo shikimin e syve të tu, që të mos shohin atje ku sprovohen.

I besoi (iu mbështet) vetes së tij

Është ai njeri që nuk u mbështet te mbrojtja dhe suksesi Hyjnor.

Çdo sprovë fillon me dashurinë për dynjanë

Burimi i tundimit është dashuria për dynjanë. Kjo është gjendja reale. Nëse ne shikojmë botën, përgjatë gjithë historisë, do të shohim se origjina dhe baza e grindjeve, e devijimeve dhe e konfuzionit midis së drejtës dhe të gabuarës, është për shkak të dashurisë për dynjanë.

Gjithashtu, ka shumë çështje dhe probleme që fillesat e tyre i kanë te dashuria për dynjanë, për pozitën shoqërore, krenarinë, dashurinë për familjen dhe shoqërinë. Në

realitet, këto çështje janë prej urtësive të çuditshme. Nëse do të shohim kudo në botë, do të gjejmë se gjendja është e tillë.

Mos ki zili askënd, për shkak të pasurisë së tij

Ky është një nga burimet e sprovave në shoqërinë tonë. Këtë e hasim në momente të ndryshme në jetën e disa individëve me karakter të dobët. Ata kanë zili njerëzit, për shkak të shtëpive të tyre të mëdha, luksit të tepërt, makinave të shumta etj.

Me shtimin e pasurisë, shtohen edhe gjynahet, për shkak të detyrimeve dhe të drejtave

Kur shtohet pasuria e një personi, të drejtat dhe detyrat e tij rriten. Kjo bën që të shtohen gjynahet. Është e ditur se, nëse të drejtat dhe detyrat janë të shumta, një person nuk është në gjendje t'i përmbushë ato. Nëse do të ishte në gjendje, ai nuk do të kishte asnjë gjynah. Kjo është nëse pasuria është fituar nga puna hallall, sepse, nëse ajo është fituar nga harami, çështja do të ishte shumë më keq.

Ajo që nënkuptohet nga referimi i këtij hadithi, ka lidhje me fitimin e pasurisë përmes haramit. Kjo do të thotë se, kur një person e fiton pasurinë përmes haramit, ai duhet

të ketë humbur shumë të drejta, përderisa ishte në gjendje të fitonte shumë pasuri.

Mos përkrahni askënd, derisa të dini se Zoti është i kënaqur me të

Nëse shihni njerëz të mbledhur rreth dikujt, që e përkrahin atë, e lavdërojnë etj, mos u kënaqni për të, për aq kohë sa nuk e dini, nëse Zoti është i kënaqur me të apo jo. Askush nuk e di se çfarë mund të fshehë ai në brendësinë e tij: shthurje, korrupsion apo probleme që e largojnë kënaqësinë e Zotit të Madhëruar. Atëherë, cila është dobia e përkrahjes së njerëzve? Në të vërtetë, cili është përfitimi i mbështetjes së njerëzve, edhe nëse ajo është e vërtetë?!

Mos kini zili një person që njerëzit i binden

Nëse shihni që njerëzit i binden një personi dhe i pranojnë urdhrat dhe udhëzimet e tij, mos e kini zili, sepse ky nuk është vendi i lumturisë.

Kur njerëzit që i binden atij, e ndjekin atë në rrugën e gabuar, atëherë ajo është humbje dhe shkatërrim, jo vetëm për të, por edhe për ata që e pasojnë atë

Lusim Allahun e Madhëruar, që për hir të të pagabueshmëve (Profetit dhe Ehli Bejtit), të na mbrojë ne nga pasimi apo ndjekja e rrugës së gabuar, si dhe të mos na sprovojë me çështje të tilla.

Epoka jonë është periudha e thirrjes në asketizëm

Le të supozojmë se ky transmetim nuk ka kurrfarë baze, por padyshim ai përmban në vetvete urtësi të larta, që na udhëheqin në rrugën e udhëzimit. Në mënyrë faktike, ai është rregull dhe udhëzues i dijeve hyjnore dhe islame. Prandaj është e përshtatshme që t'i përmbahemi.

Arsyeja e përzgjedhjes sime të këtij transmetimi të veçantë është se shoqëria jonë, sot, po kalon nëpër rrethana që e bëjnë të domosdoshme shfaqjen me qartësi të transmetimeve që kanë të bëjnë me temën e asketizmit. Shumë predikime dhe transmetime, në lidhje me asketizmin, janë përmendur në veprën "Nehxhul Belaga". Por, kjo nuk do të thotë se asketizmi është grada më e lartë për një person. Ndonjëherë vëmë re se grada e asketizmit është më e larta, ndërsa në momente të tjera, vërejmë se

grada e adhurimit, e xhihadit, ose e kërkimit të dijes është më e larta.

Janë rrethanat e kohës ato që e përcaktojnë për ne, kur asketizmi është pozita më e mirë dhe grada më e lartë se e të gjithë detyrave të tjera. Unë besoj se kjo periudhë është koha kur njerëzit dhe shoqëria duhet të thirren në asketizëm, sepse shoqëria po shkon drejt grumbullimit të pasurisë. Pasuria në vendin tonë është në rritje. Ka njerëz, në ndonjë vend në botë, që janë në gjendje të grumbullojnë pasuri dhe ta shpenzojnë atë në mënyra të ndryshme (pa e shpërndarë atë).

Le të supozojmë se ata janë të zënë me mbledhjen e parave dhe pasurisë përmes rrugëve hallall. A do të tundohen ata nga dynjaja? A do të përkeqësohet përfundimi i tyre? Të gjithë do të sprovohen në këtë dynja.[6]

Udhëheqësi është shembulli dhe modeli për njerëzit në asketizëm

Qeveria islame ka kuptim të veçantë, nuk është një qeveri e kësaj bote. Nuk është qeveri tirane. Nuk është një qeveri e sundimit mbi njerëzit. Ajo nuk ekziston për të rrëmbyer dhe për të zhvatur ata që janë në pushtet dhe për

[6] Fjala e Imam Khameneit *(Allahu i dhëntë jetë të gjatë!)*, në hapjen e sezonit "Studim shkencor". 05.09.1995.

të plotësuar qejfet dhe epshet e tyre. Qeveri islame do të thotë që zyrtarët e saj të punojnë për Islamin dhe për Zotin, jo për veten dhe dëshirat e tyre.

Ne duhet të jemi në shërbim të njerëzve. Këtë nuk e bëjmë për t'u lavdëruar, por e bëjmë me plot kuptimin real dhe faktik që nënkupton ky term. Ne duhet, që në çfarëdo pozicioni që të jemi, ta largojmë plotësisht si koncept (edhe pse mund të përdorim fuqinë që kemi në dispozicion, për të siguruar nevojat dhe dëshirat tona personale, nuk duhet ta bëjmë këtë). Zyrtarët shtetërorë duhet të jenë model në asketizëm, në raport me të tjerët, në kuptimin e vërtetë të fjalës. Kufiri i devotshmërisë është ai që na e frenon dëshirën për luksin e dynjasë.

Më mbështetni me devotshmëri dhe përkushtim

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, në letrën e tij të njohur, drejtuar Othman ibn Hunejfit, i cili ishte nëpunësi i tij në Basra, pasi e përgëzoi Othmanin për festën ku ishte ftuar, i referohet stilit të jetës së tij të nderuar, duke thënë: *"Imami juaj është mjaftuar në dynjanë e tij me vjeturina dhe në ushqimin e tij me grimca (thërrime)"*.[7] Pastaj shtoi: *"Edhe ju, a nuk jeni në gjendje të bëni diçka të tillë?"*.

[7] "Nehxhul Belaga", Letra 45.

Si duhet të veprojmë ne, ti dhe unë, që të mund të arrijmë atë pozitë të lartë? A është e thjeshtë? Çështja nuk është rritja e përgjegjësisë për veten tonë. Për aq kohë sa mundemi, ne duhet të punojmë. Këtë nuk e bëjmë për të justifikuar veten tonë, por sepse kjo mënyrë e jetës nuk mund të prodhohet. Ajo bazohet në një shpirt të çeliktë. Ai shpirt i çeliktë gjendet te Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Më mbështesni me devotshmëri dhe përkushtim*". Duhet të tregoheni sa më të devotshëm. Pasojeni këtë rrugë. Nëse kjo rrugë nuk është e lehtë për ju, atëherë veproni me aq sa keni mundësi.

Kur vendosim të ngremë parulla dhe themi: "Shoqëria jonë duhet të largohet nga të qenit vetëm konsumatore dhe të çlirohet nga konceptet e promovuara nga Perëndimi.", kjo është një çështje që varet nga puna jonë. Ne jemi ata që duhet të edukojmë njerëzit. A mund të presim që njerëzit të largohen nga luksi? Në të njëjtën kohë, jemi ne që po mbytemi nga format e ndryshme të luksit, të nderimeve dhe të dekorimeve. Kur lëshojmë diku një parullë, duhet të veprojmë sipas tij.[8]

[8] Takim me një grup funksionarësh dhe nëpunësish të Republikës Islamike, më 05.12.1990.

Largimi nga prirjet aristokratike

Vëllezër, Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!),* na fton që ta kthejmë jetën tonë në drejtim të asketizmit.

Në këtë periudhë, nëse ndiejmë që jeta po shkon drejt prirjeve aristokratike, atëherë është e sigurt që është një devijim nga i cili nuk mund të shkëputemi.

Ne duhet të drejtohemi drejt asketizmit. Me këtë nuk nënkuptojmë asketizmin që janë të dashurit e Zotit. Jo, kërkoni gradën e parë, gradën e dytë, por edhe gradët e tjera. Të gjithë duhet të ecim drejt asketizmit. Secili sipas mundësisë së tij, derisa të arrijmë te masa e gjerë e njerëzve të thjeshtë. Masa e gjerë, gjithashtu, nuk duhet të bëjë një jetë ekstravagante drejt luksit dhe pompozitetit. Asketizmi nuk është i kufizuar vetëm te zyrtarët. Është e gabuar ajo që shohim për mehrin (prikën) e lartë, kur e vendosin për martesën e vajzave të tyre. Ne nuk themi se është e ndaluar, por është një dukuri e gabuar dhe e shëmtuar në shoqëri. Në këtë mënyrë, ajo vendos vlerat njerëzore në gradën e vlerës së arit dhe të pasurisë. Në shoqërinë islame nuk ekziston një model i tillë.

Kjo sjellje nuk është e saktë. Ajo nuk tregon racionalitet dhe është në kundërshtim me arsyen dhe logjikën e shëndoshë. I Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e martoi vajzën e tij

me një mehër prej njëzet e pesë okë argjend. Ajo ishte sasia e njohur si mesatare në atë kohë. Kështu veproi edhe Prijësi i besimtarëve, edhe Ehli Bejti.

Largimi nga detyra që të është ngarkuar, është tradhti

Pjesë dhe aspekt i jetës është zbukurimi dhe rritja e luksit në jetën personale. Të gjitha këto janë veprime të gabuara. Ndonjëherë është e nevojshme të ndërtohen sheshe dhe të shtrohen rrugë të bukura dhe të mira. Kjo nuk është tema e hulumtimit tonë. Ajo që kemi për qëllim, lidhet me njerëzit, me mua dhe ju.[9]

Zyrtarëve u është besuar zbatimi i detyrave të tyre. Kushdo që largohet nga kryerja e detyrës që i është ngarkuar dhe shpërqendrohet në detyra të tjera, po tradhton besimin (amanetin) që i është dhënë dhe do të jetë burim i mallkimit të përjetshëm.

Ne jemi përgjegjës. Ne duhet të ringjallim shpirtin islam brenda nesh. Duhet të largohemi nga fryma e aristokracisë, e emancipimit, nga përfitimi personal dhe nga ndjekja e interesave personale, nga kërkimi i pasurisë dhe i luksit e të ngjashme me to. Nëse zbulojmë se disa nga problemet tona nuk po zgjidhen, shkaku dhe arsyeja është

[9] Hadithi i Uelasë (Enciklopedia e ligjëratave të Imam Khameneit *(Allahu i dhëntë jetë të gjatë!)*, vëll. 7, f. 40-55.

kjo që cituam më sipër dhe është ajo që duhet ta rregullojmë.[10]

Pasojat e gjynaheve

Shikoni gjynahet dhe mëkatet e ndryshme që kryen njeriu. Shihni veprat që burojnë nga pasimi i epsheve, i dashurisë për botën dhe i lakmisë për të, nga dashuria për pasurinë, kërkimi i pozitave, të qenët koprrac kur ke mundësi, duke shtuar këtu cilësitë e zilisë dhe të zemërimit. Është e sigurt se ajo lë dy gjurmë në qenien njerëzore, e para, është ndikimi shpirtëror, që largon prej shpirtit pastërtinë e tij, shuan shkëlqimin e dritës në të, zbeh largpamësinë shpirtërore te njeriu dhe para tij ndërpritet Rruga e mëshirës së Allahut.

Ndikimi i dytë: Ai shfaqet në arenën e aktivitetit shoqëror, ku lëvizja e jetës kërkon seriozitet, qëndrueshmëri dhe vullnet të fortë. Aty ku mëkatet kanë mbushur qenien njerëzore, ato largojnë gjithçka që ai ka dhe është në dorën e tij, nëse nuk janë në dispozicion elementet e tjera që t'i kompensojnë këtë dobësi.

Është normale që një person, ndonjëherë, mund të ketë faktorë të tjerë që e kompensojnë atë. Sikurse janë

[10] Takim me masën e gjerë të popullit, më 22.05.2002.

cilësitë e mira dhe veprat e mira, por ato nuk janë objekt i studimit tonë. Ndërsa, faji në vetvete, ka ndikimet e tij.[11]

Fitorja e armikut është rezultat i dhënies pas dynjasë

Është fatkeqësi që disa njerëz janë të shqetësuar për të ngritur lart armikun dhe nënçmojnë veten e tyre. Ata vetëm përsëritin frazën e fitores së armikut dhe vijojnë të përsëritin shprehjen: "Ne nuk mundemi". Kjo do të thotë që ne, si shumë shtete dhe qeveri, duhet të përpihemi nga arroganca globale dhe të drejtat tona të injorohen.

Ata e kanë gabim. Ata janë të dobët dhe të zbrazët nga brenda. Ose ishin të tillë që në fillim, ose u bënë bosh duke ndjekur kënaqësitë dhe bukuritë e dynjasë, dhe ato i bënë të tillë. Dhënia pas dynjasë i bëri ata të pavlerë dhe pa identitet. Ata vetëm mashtrohen. Të gjithë janë njësoj e ngjasojnë me ata.[128]

Kjo është arsyeja, pse ne gjejmë se disa nga ata që punojnë në fushën e ideve, e tejkalojnë ligjin. Sidoqoftë, fusha e ideve dhe e shkencës ka ligjet e veta që duhet të ndiqen. Nëse dikush ka ndonjë dyshim në lidhje me fushën intelektuale, atëherë ligji kërkon që ajo të paraqitet në qendra të specializuara dhe forume shkencore. Atëherë, ose ai e zgjidh këtë dyshim dhe e heq nga mendja e tij, ose ai e

[11] Hytbja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 17.01.1997.
[12] Takim me përfaqësues të popullit, më 22.05.2002.

kthen atë në një teori dhe i bind studiuesit që ta shohin se ai është një problem real. Këta zotërinj nuk e pasojnë këtë ligj. Por, sapo të shfaqet ndaj tyre një dyshim, ai e trondit besimin e tyre. Kjo vjen edhe si rezultat i sprovave, i vështirësive të shumta, i lakmisë, i pasionit e i dashurisë për dynjanë. Këto ua rrëmbejnë nga zemra bazat e besimit të tyre. Ata bien në dyshim. Më pas, dyshimin e përhapin në publik. Këtë e emërtojnë "Rishqyrtim". Në të vërtetë, kjo është tradhtia ndaj ideve publike.

Çfarë do të thotë rishqyrtim? Ndonjëherë rishqyrtim do të thotë kthim për t'u informuar dhe rishikim i drejtë i gabimeve. Në këtë rast, është një gjë shumë e mirë. Por, për sa i përket rishikimit të pikëpamjeve politike, që janë rezultat i interesave të ngushta, ndodhin nga ndryshimi i rrethanave dhe i situatave, si dhe nga mashtrimi i armiqve. Ky nuk është një rishqyrtim, por përkundrazi është devijim i rrugës.

Ne në Islam kemi parimin e ixthihadit të përhershëm. Ai ka për qëllim që njeriu i ideve dhe i mendimeve të plotësojë idenë dhe pikëpamjen e tij.

Në procesin e integrimit, ndonjëherë një njeri korrigjon gabimin e tij. Ky është veprim i drejtë dhe i pëlqyeshëm. Edhe në procesin e mendimit islam, studiuesit dhe mendimtarët që kanë aftësinë e ixthihadit (kërkimit) dhe të Instinbatit (nxjerrjes) në strukturat intelektuale dhe

teorike të revolucionit, përherë duhet të mendojnë se si ta plotësojnë këtë mendim. Kjo është një gjë e mirë.

Fatkeqësisht, jo të gjithë ata që e pretendojnë atë, kanë kompetencat e nevojshme shkencore dhe intelektuale.

Ne nuk duhet të jemi pasues të "Partisë së erës". Të anojmë andej nga ajo shkon, ose të shohim si armik këdo që ajo sheh, ose të pozicionohemi në çfarëdo pozicioni që ajo merr. Të përputhim pozicionet tona me të. Nëse ajo mërzitet, edhe ne shfaqemi të trishtuar. Nëse ajo flet ashpër, ne i shfaqim kërkimin e ndjesës. Kjo çështje është e papranueshme.[13]

[13] Fjalim i Imam Khameneit *(Allahu i dhëntë jetë të gjatë!)*, në takim me të rinjtë e Esfehanit, më 27.02.2002.

KAPITULLI I DYTË

RËNIA E NJERËZVE TË VEÇANTË DHE ASKETIZMI I VERBËR

Sa bujar i mirë është Talha!

Said ibn El Asi ishte një nga Beni Umejet dhe një i afërm i Othmanit. Ai u shfaq në skenë pas El Uelid ibn Ukba ibn Ebi Mui'jt, për të rregulluar atë që ishte prishur nga El Uelidi.

Një ditë, një burrë, në kuvendin e tij, i tha: "'Sa bujar i mirë është Talha!' Talha duhet t'i ketë dhënë dikujt para, ose është treguar bujar ndaj atij".

Said ibn El Asi i tha: "Ai që zotëron një 'Neshastenxh', duhet të jetë bujar". "Neshastenxhi" ishte një fermë e madhe me korra të bollshme afër Kufas, në pronësi të shokut të Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, Talha ibn Abdullahit. Në atë kohë ai jetonte në Medine.

Pastaj shtoi: "Pasha Allahun, po të zotëroja diçka si ai, do të kisha vepruar shumë herë më mirë se ai".

Nuk është nevoja të thuash se ai është bujar, ose të thuash se sa bujar i mirë është Talha.

Krahasoni këtë situatë me gjendjen e asketizmit gjatë periudhës së të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, si dhe periudhën e parë pas largimit të tij nga kjo botë. Vini re mënyrën e jetesës së sahabëve të mëdhenj, udhëheqësve dhe shokëve të tjerë të Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi*

familjen e tij!), të cilët kanë jetuar në ato vite, si dhe mënyrën se si ata e shihnin dynjanë.

Pas 10 ose 15 vitesh, gjendja arriti në këtë pikë.

Ebu Musa El Esh'arij dhe dyzet mushkat e tij

Një shembull tjetër është Ebu Musa El Esh'arij, guvernatori i Basrës. Ebu Musa El Esh'arij është i njohur nga qëndrimi i famshëm në çështjen e arbitrazhit. Ai një ditë u ngjit në minber, ndërkohë që njerëzit po përgatiteshin për një nga betejat e luftës. Filloi t'i nxiste njerëzit për xhihad. Ai përmendi shumë hadithe për vlerën e xhihadit dhe pozitën e dëshmorit. Shumë njerëz nuk kishin kafshë të hipnin për të shkuar në luftë. Secili duhet të hipte në kalin e tij dhe të shkonte. Për t'i nxitur ata të shkonin në këmbë, ai e ekzagjeroi vlerën e xhihadit në këmbë.

Ai tha: "Ai ka një vlerë të madhe dhe një shpërblim të madh!". Fjalimi i tij ishte aq shumë entuziast, sa disa prej tyre i lanë kafshët e tyre.

Ata thanë: "Le të shkojnë burrat, pse kuajt?!". Këtë e bënë me shpresën e shpërblimit më të madh. Kështu që ata e lanë kalin e tyre.[14]

[14] Ibn El Ethijr, "El Kamil fi Tarijkh", vëll. 3 f. 99-100; Et Tabarij, "Tarijkh Et Tabarij", vëll. 3, f. 320.

I lanë kuajt dhe nuk i morën, sepse kjo i privonte nga shpërblimi. Sidoqoftë, një grup njerëzish të tjerë të mençur medituan dhe pritën të shihnin faktet dhe thanë: "Ne nuk po ngutemi për diçka, derisa të shohim se çfarë do të bëjë vetë ai. Të shohim, nëse fjala e tij do të përputhet me veprën e tij. Ne do të veprojmë si do të veprojë ai".

Ibn El Ethijri thotë: "Kur u largua nga pallati i tij, ai e mori pasurinë e tij në dyzet mushka".[15] Këto ishin pasuritë e tij të çmuara. Ai ishte i detyruar t'i merrte ato kudo që shkonte dhe udhëtonte, madje edhe në fushën e xhihadit. Në atë periudhë nuk ekzistonin bankat. Qeveritë nuk i vlerësonin ato. Urdhri nga Kalifi, për ta larguar nga pozicioni i tij, mund të vijë, ndërsa ai është në fushën e xhihadit. Nëse do të ndodhte kjo, atëherë ai nuk mund të kthehej në Basra dhe t'i merrte ato pasuri, kështu që ai ishte i detyruar t'i mbante me vete. Ai i mbajti pasuritë e tij të çmuara në dyzet mushka në fushën e xhihadit.

Kur ai u nis, erdhën disa njerëz, e kapën për freri kalin e tij dhe i thanë: "Na shuaj kuriozitetin. Na lejo të hipin në këto mushka, sepse ne dolëm në këmbë. Çfarë janë gjithë këto gjëra që i ke marrë me vete në fushën e betejës?! Eja ec me ne në këmbë, ashtu siç fole".

[15] I njëjti burim.

Ai i goditi njerëzit me kamxhikun e tij. Ata e lëshuan kafshën e tij dhe ai vazhdoi rrugën.[16] Ata u shpërndanë, por natyrisht nuk e duruan atë mënyrë sjellje të tij. Shkuan në Medine dhe u ankuan për të tek Othmani. Ai e largoi atë nga ajo pozitë. Edhe pse Ebu Musai ishte një nga shokët e të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!)*, edhe pse ai ishte prej sahabëve të afërt dhe të mëdhenj, ai ishte në një gjendje të tillë.

Sad ibn Ebi Uekasi dhe plaçkitja e thesarit

Shembulli i tretë është Sad ibn Ebi Uekasi, i cili u emërua guvernator i Kufës. Ai kishte marrë hua para nga thesari i shtetit. Në atë periudhë, thesari nuk ishte në duart e guvernatorit. Guvernatori emërohej për të trajtuar çështjet qeveritare dhe për të menaxhuar punët e njerëzve. Dikush tjetër emërohej për të trajtuar çështjet financiare. Ai ishte përgjegjës drejtpërdrejt te kalifi.

Kur u emërua Sad ibn Ebi Uekasi guvernator në Kufe, arkëtari i thesarit ishte Abdullah ibn Mesudi. Ai ishte një sahab i ndritur. Pasi personi i parë (guvernatori) mori hua nga thesari disa mijë dinarë - të jem i saktë, nuk më kujtohet sa ishte shuma - dhe nuk iu përmbajt afatit të kthimit të borxhit, Abdullah ibn Mesudi kërkoi borxhin, por

[16] "El Kamil fi Tarijkh", f. 99.

ai nuk e kishte të mundur ta kthente atë. Debatuan mes tyre për këtë gjë. Konflikti u rëndua.

Hashim ibn Utbetu ibn Ebi Uekasi ishte i pranishëm. Ai ishte një nga shokët e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, dhe ishte një njeri i nderuar. Ai tha: "Ju jeni shokët e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!)* dhe po ju shohin". Pra, mos u grindni. Zgjidheni këtë çështje ndërmjet jush, në një farë mënyre.

Abdullah ibn Mesudi doli. Ai ishte një njeri i besueshëm. Atëherë ai kërkoi ndihmë nga njerëzit, për të nxjerrë paratë nga shtëpia e Sadit. Kjo do të thotë se paratë ishin atje. Kur Sadi e mësoi këtë gjë, kërkoi ndihmë nga njerëz të tjerë dhe u kërkoi atyre t'i ndalonin. Zvarritja e Sad ibn Ebi Uekasit në kthimin e parave rezultoi në një mosmarrëveshje të ashpër.

Sadi, i cili ishte një nga gjashtë shokët e Shuras, kishte arritur në këtë pikë pas disa vitesh. Ibn El Ethijri e përshkroi atë incident në këtë mënyrë: "Ishte incidenti i parë në mesin e banorëve të Kufes".[17] Ajo u shkaktua nga një njeri i veçantë. Tek ai triumfoi dashuria për dynjanë, deri në atë masë, saqë e shfaqi nënshtrimin e tij ndaj saj, ndaj dynjasë.

[17] "El Kamil fi tarijh", f. 82.

El Uelid ibn Ukbetu, guvernatori i shthurur i Kufes

Një incident tjetër që ndodhi, është se Othmani e shkarkoi Sad ibn Ebi Uekasin si guvernator nga Kufe dhe në vend të tij emëroi El Uelid ibn Ukbetu ibn Ebi Mui'jt. Ai ishte nga fisi i Umejadëve dhe ishte nga të afërmit e kalifit. Kur ai hyri në Kufe, banorët e saj u çuditën, se si një person i tillë do të ishte guvernator i tyre. Ai njihej se ishte budalla dhe i shthurur. Për të u shpall ajeti fisnik: "O ju që keni besuar! Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë), për të mos i bërë dëm ndokujt pa dashje, e të pendoheni pastaj për atë që keni bërë.".[18], d.m.th., Kur'ani e përshkroi atë si një njeri të pandershëm. Ai u solli lajme të dëmshme disa njerëzve në periudhën e të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!)*.

Shikoni standardet dhe cilësitë, si dhe ndryshimin e gjendjes së njerëzve. Ky person, që Kur'ani e cilësonte të pandershëm dhe njerëzit e lexonin çdo ditë, arriti dhe u bë këtu një guvernator.

Edhe vetë Sad ibn Ebi Uekasi dhe Abdullah ibn Mesudi u habitën, kur e panë atë duke ardhur në Kufe si guvernator. Abdullah ibn Mesudi, kur e pa që ai ishte

[18] Sure "El Huxhurât", ajeti 6.

zgjedhur guvernator, i tha: "Unë nuk e di nëse u ndreqe pas nesh, apo njerëzit janë prishur".

Sad ibn Ebi Uekasi u habit nga një dimension tjetër dhe i tha: "A je bërë i ditur pas nesh, apo ne jemi bërë budallenj pas teje?"

El Uelidi iu përgjigj: "Mos u shqetëso për Ebu Is'hakun. Asgjë prej këtyre nuk ishte. Përkundrazi është mbreti ku disa njerëz tek ai drekojnë dhe të tjerët darkojnë".[19] Pra, mos u trishtoni, sepse unë nuk jam i zgjuar dhe ju nuk jeni budallenj, por çështja është dhe mbetet çështje në dorën e mbretit.

Zëvendësimi i qeverisë hyjnore, kalifatit dhe kujdestarisë me mbretërinë ishte një ngjarje e çuditshme. "Disa njerëz tek ai drekojnë dhe të tjerët darkojnë". Sot është për atë dhe nesër për të tjerët.

Sad ibn Ebi Uekasi u hidhërua shumë nga këto fjalë. Ai ishte një nga shokët e të Dërguarit të Allahut. I tha: "Unë po shoh se e keni bërë mbretëri".

Një ditë, Umer ibn El Khatabi e pyeti Selmanin: "A jam unë mbret apo kalif?"

19. Ibn El Ethijr, "El Kamil fi Tarijkh", vëll. 3, f. 83.

Selmani ishte një personalitet i madh dhe i respektuar. Ai ishte një nga sahabët e mëdhenj dhe mendimi i tij kishte peshë.

Selmani iu përgjigj: "Nëse nga toka e myslimanëve mblidhni një dirhem, ose më pak, ose më shumë dhe nuk e vendosni atë atje ku ai e meriton, atëherë ju jeni një mbret dhe nuk jeni kalif".[20]

Ibn El Ethijri ka thënë: "Pasi ai i shpjegoi standardin, Umeri qau. Këshilla që ai mori, ishte shumë domethënëse. Çështja ka të bëjë kalifatin. Kalifat do të thotë qeveri. Ajo shoqërohet me dashuri dhe lidhje të fortë me njerëzit, shoqërohet me mëshirë dhe dhembshuri për të gjithë banorët. Kalifati nuk është sundim, ose kontroll mbi popullin. Mbretëria nuk mbart të njëjtin kuptim. Ajo nuk ka asnjë lidhje me njerëzit. Mbreti është një sundimtar autoritar që bën çfarë të dojë.

Këto ngjarje ndodhën me njerëz të veçantë. Gjendja arriti në atë shkallë, vetëm disa vite pas vdekjes së Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!)*. Pra, këto çështje ndodhën gjatë periudhës së kalifëve të udhëzuar, të cilët mbanin drejtësinë, ishin të përkushtuar dhe u përmbaheshin rregullave, që kishin jetuar me periudhën e të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!)*. Jehona e thirrjes së tij ndihej

[20] "El Kamil fi Tarijkh", f. 59.

ende e gjallë në Medine. Kishte njerëz si Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja qoftë mbi të!)*, që ishte ende i pranishëm në atë komunitet. Ndodhi të tilla u përhapën në masë të madhe, pasi qendra e kalifatit u zhvendos në Damask.

Mjaftojnë këta shembuj modestë, për të treguar gjendjen ku ndodheshin këta njerëz të veçantë. Nëse një person do të thellohej në historinë e Ibn El Ethijrit, ose në burime të tjera historike që merren në konsideratë nga vëllezërit tanë myslimanë, aty do të gjenin me mijëra shembuj të tillë.

Prishja e shpirtrave prodhon njerëz si rabini hebre, Ka'b

Është e natyrshme se, kur humbet drejtësia dhe, kur zhduket robëria ndaj Zotit, atëherë shoqëria kthehet në një shoqëri të zbrazët, me shpirtra të korruptuar. Në shoqëri të tilla, çështja arrin deri aty sa fillon grumbullimi personal i pasurisë dhe dashuria për jetën në dynja arrin kulmin.

Gjithashtu, shoqëria nxjerr në pah njerëz si rabini hebre, me emrin Ka'b, i cili u përcjell njerëzve dijen fetare, edhe pse e pranoi vonë Islamin. Ai nuk jetoi në periudhën e Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Ai nuk hyri në Islam në kohën e të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen*

e tij!), as gjatë sundimit të Ebu Bekrit, por gjatë periudhës së Omerit dhe vdiq gjatë sundimit të Othmanit.

Disa thonë se ai është Ka'b El Akhbari. Nuk është e vërtetë. E vërteta është se ai quhet Ka'b El Ahbar (Ka'b rabini).

"El Ahbar" – "rabinët" është shumësi i fjalës "habr" – "rabin". Rabin është dijetar hebre. Ka'bi ishte boshti i dijetarëve hebrenj (dijetari më i njohur hebre). Shohim se si ai ka hyrë në Islam. Më vonë shohim se ka filluar të trajtojë çështjet e Islamit.

Një ditë, Ka'bi ishte ulur në mexhlisin (kuvendin) e Othmanit. Kur Ebu Dherri hyri, Ka'b el Ahbari tha një fjalë që e zemëroi Ebu Dherrin. Ebu Dherri i tha: "Kush je ti? Çfarë bën këtu?! Po na e mëson Islamin dhe rregullat e tij, ndërsa ne e dëgjuam atë nga i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*?!" [21]

Kur humbasin standardet, minohen vlerat, zbrazen çështjet nga përmbajtja e tyre dhe kufizohen vetëm në dukuri. Kur sundon dashuria për dynjanë, grumbullimi i pasurisë i kap njerëzit që deri më sot kanë kaluar një jetë të gjatë me krenari dhe asketizëm ndaj zbukurimeve të dynjasë. Pikërisht atyre që u është dhënë mundësia ta ngrenë lart flamurin, në atë kohë çështjet e kulturës dhe e dijeve u adresoheshin njerëzve të tillë, si ai person. Ai e

[21] "El Kamil fi Tarijkh", f. 115.

përqafoi Islamin më vonë. Ai flet në emër të Islamit atë që ai personalisht e sheh të arsyeshme dhe jo atë që thotë Islami. Më vonë vijnë disa të tjerë dhe argumentojnë me thënien e tij si një thënie e një myslimani i cili ka hyrë herët në besim.

Devotshmëria e zyrtarëve i mbron edhe të tjerët

Të dashurit e mi!

Ashtu sikurse e dini, njeriu nuk pajtohet me realitetin e zhvillimeve të tilla shoqërore, vetëm se pas një kohe të gjatë. Për këtë arsye, duhet t'i kushtojmë vëmendje dhe të jemi të kujdesshëm. Kjo është devotshmëria. Devotshmëri do të thotë të kesh kujdes dhe ta ruash veten nga mendjemadhësia, sidomos ai që ka pozitë dhe autoritet. Ata që gjykojnë, janë në pozitë më të lartë se autoriteti i tyre mbi vetë veten.

Gjithashtu, ata duhet të kujdesen për veten e tyre dhe t'u kushtojnë vëmendje të tjerëve. Ndërsa ata që qëndrojnë në krye të pushtetit, duhet të ruhen nga vetvetja dhe shoqëria në tërësi, në mënyrë që të mos rrëshqasin drejt dynjasë, si dhe të mos kapen pas bukurive të saj. Vetëm kështu ata kujdesen që të mos bien në humnerën e dashurisë për vetveten.

Sigurisht, kjo nuk do të thotë të braktisësh ndërtimin e shoqërisë. Ata duhet ta ndërtojnë shoqërinë dhe të shtojnë

pasurinë e saj, por jo të kërkojnë ta marrin për vete pasurinë. Marrja e pasurisë për vete është e papranueshme. Çdokush që ka aftësinë për të rritur pasurinë e shoqërisë dhe për të realizuar arritje të mëdha, do të marrë shpërblime të mëdha.

Disa njerëz kanë bërë të mundur që gjatë këtyre viteve të ndërtojnë vendin. Ta ngrenë lart flamurin e rindërtimit. Të kryejnë vepra të mëdha. Kjo punë i bën ata krenarë. Puna e tyre është brenda kornizave të dashurisë për dynjanë. Dashuria për dynjanë është atëherë kur një person kërkon përfitime për veten e tij, punon për veten, ose mendon të mbledhë pasuri për veten e tij nga arka e shtetit të myslimanëve. Kjo është e gabuar.

Prandaj, duhet të bëni kujdes nga rënie dhe rrëshqitje të tilla. Nëse nuk bëni kujdes, shoqëria gradualisht do të shkojë drejt braktisjes së vlerave dhe do të arrijë një fazë, ku nuk do të mbetet asgjë (nga Islami dhe vlerat e tij), përveç lëvozhgave historike. Mund të sprovohet me fatkeqësi të rënda. Ajo vjen në momentin që nuk e pret dhe mund t'ju kapë në befasi. Si p.sh. sprova që kaloi kjo shoqëri, kur shpërtheu revolucioni i Ebu Abdullahit, Imam Hysejnit *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Të zgjedhësh ndërmjet postit guvernator në Rraj, ose të biesh dëshmor

Omer ibn Sadit i thanë se do ta caktonin guvernator në zonën e Rrajit. Në atë periudhë Rraji ishte një zonë e gjerë dhe e pasur. Pozicioni i guvernatorit, në atë kohë, nuk ishte i njëjtë me atë të guvernatorit në kohën e sotme. Guvernatorët sot janë punonjës të qeverisë, të cilët marrin paga dhe bëjnë përpjekje të mëdha. Por në atë kohë nuk ishte e njëjta gjë. Personi që emërohej guvernator kishte dorë të lirë dhe zotëronte të gjithë pasuritë në qytet. Ai e menaxhonte atë siç dëshironte. Një pjesë të saj e dërgonte në kryeqytetin e kalifatit. Kjo është edhe arsyeja pse pozicioni i guvernatorit kishte një rëndësi të madhe.

Ata i vunë kusht Omer ibn Sadit, se do ta emëronin guvernator, që të shkonte të luftonte Imam Hysejnin *(Paqja qoftë mbi të!)*. Në këtë moment, njeriu fisnik dhe me vlera nuk heziton për asnjë moment që ta refuzojë një ofertë të tillë. Është sikur t'i thonë: "Vdis dhe bëhu guvernator në Rraj".

Çfarë vlere ka Rraji? Edhe nëse do të më jepej e gjithë dynjaja, unë nuk do ta bëja, po qe se vrenjtej në fytyrë Imam Hysejni *(Paqja qoftë mbi të!)*. Si të mund të ngrihesh për të luftuar të shtrenjtin e Zehrasë *(Paqja qoftë mbi të!),* ta vrasësh atë dhe fëmijët e tij? Ky është qëndrimi i personit që mbart vlera.

Por, kur shoqëria është e zbrazët dhe pa vlera, si dhe, kur dobësohen parimet themelore ndërmjet anëtarëve të shoqërisë, dalin dredhitë e rrenat. Ajo që mund të bëjë një person në një situatë të tillë, është t'u japë afat atyre një natë për t'u menduar mbi çështjen, të cilën, edhe nëse do ta kishte menduar për një vit të tërë, do të kishte arritur në të njëjtin përfundim dhe do të kishte marrë të njëjtin vendim, pasi një model i tillë i të menduarit nuk ka asnjë vlerë. Sidoqoftë, ai njeri e mendoi atë brenda natës dhe njoftoi të nesërmen se ishte dakord me atë ofertë. Allahu i Madhëruar nuk ia mundësoi atij të arrinte qëllimin dhe rezultati i saj, të dashurit e mi, ishte tragjedia e Kerbelasë.[22]

Khahuarixhët, asketë jo largpamës

Nëse njeriu, gjatë adhurimit të tij e neglizhon praninë e zemrës dhe shpirtin e adhurimit, që është edhe shpirti i robërimit ndaj Krijuesit, përulja ndaj Zotit dhe dorëzimi tek Ai, atëherë ai do të ekspozohet ndaj rreziqeve të ndryshme, njëra prej të cilave është ngurtësimi.

Disa khauarixhë, emrat e të cilëve ju i keni dëgjuar shumë, adhuronin shumë Zotin. Ata luteshin, me frikë dhe respekt, duke recituar ajete të Kur'anit, deri në atë masë sa

[22] Hytbja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 08.05.1998.

disa nga shokët e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!),* u ndikuan prej tyre.

Gjatë ditëve të Luftës së Devesë, një nga shokët e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!),* ishte duke ecur dhe sheh një prej tyre duke u lutur në mes të natës dhe duke recituar me një zë melankolik ajetet kur'anore: "A mund të krahasohet ai që falet natën, duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë e që ruhet prej Jetës Tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të tij (me jobesimtarin)?! Thuaj: 'A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Vetëm mendarët i pranojnë këshillat!'"[23].

Ai erdhi te Prijësi i besimtarëve *(Paqja qoftë mbi të!)*. Ishte i hutuar. Gjendja e tij kishte ndryshuar. Prandaj, ne shpesh shohim se edhe njerëzit inteligjentë, të arsyeshëm dhe të ditur dhe shumica e shokëve të ngushtë të Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!),* gjithashtu, bëjnë gabime. Nisur nga këtu, e kuptojmë se Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!),* nuk tha më kot në hytben (ligjëratën) e tij të njohur se: *"Unë shova syrin e kryengritjes dhe askush tjetër nuk do të kishte guxuar ta bënte, pasi ajo ishte përhapur"*.[24]

[23] Sure "Ez Zumer", ajeti 9.
[24] "Nehxhul Belaga", vëll. 1, f. 182.

E vërteta është se kjo çështje kërkonte shpatën e Aliut, largpamësinë dhe vetëbesimin e tij, sepse edhe ata që janë të veçantë, rrëshqasin ndonjëherë.

Sipas asaj që u përmend, Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, i tha shokut të tij: *"Unë do t'ju informoj më vonë"*.[25]

[25] Ky transmetim është për Kumejl ibn Zijadin. Është transmetuar në "Biharul Enuar", vëll. 33, f. 399, në një rrugë tjetër me pak ndryshim. "Prijësi i Besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, doli atë natë nga xhamia e Kufes dhe u drejtua për në shtëpinë e tij. Kishte kaluar çereku i natës. Me të ishte Kumejl bin Zijadi. Ai ishte nga përkrahësit e tij më të mirë dhe njerëzit e tij më të dashur. Nga rruga drejt derës së shtëpisë erdhi zëri i një burri që lexonte Fjalën e Allahut të Madhëruar: **"A mund të krahasohet ai që falet natën, duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë e që ruhet prej Jetës Tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të tij** (me jobesimtarin)**?! Thuaj: 'A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Vetëm mendarët i pranojnë këshillat!'"**.

Ai i recitonte me një zë melankolik. Kumjeli u hutua dhe u mahnit nga zëri i tij. Gjendja e këtij njeriu e çuditi dhe nuk tha asgjë. Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, u drejtua nga ai dhe i tha: *"O Kumejl, të mos të çudisë zëri i atij njeriu. Ai është nga banorët e zjarrit. Do të të tregoj për të më vonë!"*

Kumejli u hutua nga ajo që iu shfaq prej asaj që kishte në brendësinë e tij, si dhe prej dëshmisë së Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, se do të ishte prej banorëve të zjarrit. Ai shprehte një gjendje të mirë. Por, kaloi një farë kohe dhe ndodhi ajo që ndodhi me gjendjen e khahuarixhëve. Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, i luftoi ata, edhe pse e mësonin Kur'anin ashtu si zbriti. Prijësi i besimtarëve *(Paqja qoftë mbi të!)* u kthye nga Kumejl ibn Zijadi, i cili qëndronte para tij me shpatën në dorë, prej së cilës pikonin pika gjaku, ndërsa kokat e atyre qafirëve ishin të përhapura në tokë. E vendosi majën e shpatës mbi njërën prej atyre kokëve dhe tha. *"O Kumejl!* **"A mund të krahasohet ai që falet**

Kur mbaroi lufta e khahuarixhëve, mbetën më pak se dhjetë njerëz, ndërsa të tjerët u vranë. Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, donte që shokët e tij të respektoheshin. Ai eci mes të vdekurve. Në disa vende iu drejtua disave prej tyre. Kur arriti te një prej të vdekurve, u bëri me shenjë atyre për ta kthyer, sepse ishte i shtrirë në fytyrë. Ata e kthyen dhe ai u tha atyre që ta ulnin. Pastaj e pyeti shokun e tij: "A e njihni atë?" Ai nuk e njohu atë. Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, i tha se ishte ai që recitonte Kur'anin dhe u dridhte zemrën me zërin e tij.

Atëherë, çfarë është ky recitim?! Çfarë lloj adhurimi është ky?! A është ky largim nga fryma e adhurimit?!

Kur njeriu e shijon shpirtin e adhurimit, lutjes dhe Kur'anit, e kupton ekzistencën e vërtetë të Islamit dhe thelbin e tij, i cili ishte mishëruar te Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja qoftë mbi të!)*. Kur ai pozicionohet në një anë të caktuar, largohet nga të gjitha dyshimet dhe bashkohet me të. Ky largim nga Kur'ani dhe nga feja e çon individin në kuptimin

---

natën, duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë e që ruhet prej jetës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të tij (me jobesimtarin)**?! Thuaj: 'A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Vetëm mendarët i pranojnë këshillat!'"**.

Ky ishte ai personi që e lexonte Kur'anin atë natë dhe ti u mahnite nga pamja e tij".

Kumejli i puthi këmbët dhe i kërkoi falje Zotit.

e gabuar të kësaj teme dhe, si pasojë arrin në ngritjen e shpatës së tij kundër Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Pra, një nga dimensionet e çështjes, është ngurtësimi i zemrës, mungesa e reflektimit dhe gabimet e rënda që pamë gjatë gjithë sundimit të periudhës së Beni Umejes dhe Beni Abasit.

Disa njerëz ishin evlija, besimtarë, ishin njerëz të adhurimit dhe asketizmit. Librat e historisë i kanë përmendur si adhurues, asketë, njerëz të matur dhe me arsye. Vetëm se ata ishin të dyshimtë. Gabimi i tyre ishte se ata nuk mund të bënin dallimin ndërmjet frontit të së drejtës dhe frontit të së gabuarës. Gabimi më i madh është kur një person dyshon në mes të së drejtës dhe të gabuarës dhe nuk mund të bëjë dallimin midis tyre. Gabimet e vogla janë të pranueshme dhe falen. Por gabimi i ngatërrimit të fronteve të së drejtës dhe të gabuarës, duke mos njohur frontin e duhur, nuk mund të falet.

Madhështia e njerëzve të veçantë në adhurim dhe shmangia e gjynaheve

Këtu qëndron madhështia e njerëzve të ngjashëm me Amar ibn Jasirin. Madhështia e njerëzve të veçantë, si Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, qëndron në faktin se ata nuk bënë gabime në asnjë rrethanë prej

rrethanave. Ata nuk e humbën frontin e tyre. Kjo madhështi u shfaq në shumë situata gjatë Luftës së Sifinit. Ajo nuk ishte e kufizuar vetëm në këtë luftë, por edhe në shumë raste, ku disa çështje ishin ngatërruar për një grup besimtarësh. Amar bin Jasiri, me largpamësinë dhe qëndrimin e tij të qartë, largoi dyshimin. Këtu e shohim këtë person, njeri me zemër të ndritshme dhe pozitë të lartë, të qëndrojë në shumë raste që lidhen me Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!),* ndërmjet tyre edhe Lufta e Sifinit.

Lufta e Sifinit zgjati për disa muaj dhe ishte një luftë e çuditshme, sepse njerëzit shihnin përballë tyre njerëz që kryenin lutje, adhurime dhe lexonin Kur'an dhe madje e ngrinin Kur'anin në shtiza. Një person që drejton shpatën e tij përpara individëve që kryejnë lutje, ka nevojë për një zemër të guximshme dhe guxim të lartë.

Në një transmetim të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* është përmendur: *"Kishte një bekim në luftën e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) kundër Ehlul Kibles. Nëse Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) nuk do të kishte luftuar kundër tyre, askush pas tij nuk do të dinte se si të vepronte me ta".*[26]

Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja qoftë mbi të!)* ishte ai që e hapi rrugën dhe u tregoi të gjithëve se si duhet të vepronin me ta.

[26] El Shejkh Et Tusij, "Tehdhijbul Ahkam", vëll. 6, f. 145, K. 250.

Kur bijtë tanë - gjatë luftës së imponuar - pushtuan pozicionet e armiqve sulmues dhe i zunë rob ata, në barrikadat e tyre ata gjenin tespi dhe sixhade.

Ashtu si ata që qëndronin përballë Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe kryenin lutjet, edhe një grup njerëzish bënë një gabim në atë kohë. Njeriu që u përball me ta ishte Amar ibn Jasiri. Ky veprim ka nevojë për meditim dhe largpamësi. Ka nevojë për dikë si Amari.

Nëse njeriu nuk e kupton realitetin e veprave dhe frymën e adhurimeve, e cila është drejtimi dhe bindja ndaj Zotit, dhe nëse nuk i bindet çdonjërës prej këtyre obligimeve, të ofrohet më shumë me nënshtrim ndaj Zotit, atëherë veprat e tij mbeten të cekëta. Veprimet dhe besimi sipërfaqësor janë një kërcënim dhe rrezik. Kjo është ajo që ne shohim gjatë gjithë historisë së Islamit.

Asketizmi pa largpamësi, është një lojë në duart e sulltanëve (udhëheqësve)

Më herët përmenda se disa nga fillestarët e evlijave adhurues e asketë, shkonin te kalifi i padrejtë, uzurpator, gjynahqar, i poshtër, gënjeshtar dhe shpifës. Ata uleshin me të dhe e këshillonin. Flisnin me të histori nga të cilat ai qante. E qara e tij ishte mashtruese dhe hipokrite, ose ndoshta

zemra e tij ndiente diçka dhe ai qante. Disa prej tyre madje ishin të pirë dhe në gjendje shumë të dehur. Ata shfaqnin disa ndjenja. Por, kur tek ta vinte dikush për t'i folur disa fjalë – dhe ai ishte në atë gjendje - ai qante prej tyre. Në këtë rast, këta njerëz të thjeshtë e injorantë, edhe nëse kanë njohuri për rregullat e fesë, bëhen pasuesit e këtij kalifi.

Në historinë e Islamit, ne shohim shumë nga këto gjëra të çuditshme. Amr bin Ubeidi, adhurues e asket i njohur. Kalifi Abasit, Mensuri, bënte sikur e donte atë. Ai i tha: "Të gjithë kërkoni gjuetinë, të gjithë ecni ngadalë, përveç Amr ibn Ubeidit".[27] Por, nëse do të shihni Amr ibn Ubeidin, Muhamed ibn Shehab Ez Zuhrijin dhe të tjerë të ngjashëm me ta, do të shihni se ata, në kohën e tyre, ishin një nga pengesat kryesore në rrugën e të vërtetës. Me praninë e tyre, ata mbështetën frontin e të keqes dhe lanë frontin e të vërtetës. Domethënë, ata ishin kundër Ehli Bejtit të Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!)*, duke i lënë të vetëm dhe të shtypur. Për shkak të kësaj injorance, nga ana e tyre, armiqtë guxonin të vepronin mbi Ehli Bejtin e Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!)*.

[27] Es Seijd El Murteda, "El Emalij", vëll. 1, f. 122.

Fryma e adhurimit, nënshtrim ndaj Allahut të Madhëruar

Vëllezër dhe motra, ne duhet të përpiqemi të ringjallim frymën e adhurimit në shpirtrat tanë, sepse adhurim do të thotë nënshtrim ndaj Zotit. Kjo do të thotë të shkatërrosh ata idhuj që ekzistojnë në brendësinë tonë. Këta idhuj të brendshëm - që është egoja jonë - shfaqen në shumë vende. Veçanërisht kur interesi juaj është në rrezik, ose kur dikush ju kundërshton, ose ka diçka që nuk përputhet me dëshirën tuaj, edhe nëse dëshira juaj është në kundërshtim me Sheriatin, ose kur përballeni me një udhëkryq. Atëherë interesi personal qëndron në njërën anë, ndërsa detyra është në anën tjetër. Pikërisht, në këto ngushtica dhe sheshe "Uni" nxjerr kokën dhe tregon veten.

Nëse ne mund ta kontrollojmë egon e brendshme - domethënë tekat e shpirtit - këtë faraon të brendshëm, këtë djall që është brenda nesh, ose të paktën, nëse ne mund ta frenojmë atë, atëherë të gjitha punët tona do të rregullohen. Përmbi gjithçka, ne do të mund të ngjitemi në nivelin e njerëzores dhe do të gjejmë shpëtimin.[28]

[28] Pjesë nga fjala e Imam Khameneit *(Allahu i dhëntë jetë të gjatë!)*, me individë të thjeshtë të popullit, më 26.04.1999.

KAPITULLI I TRETË

IMAM ALIU *(PAQJA QOFTË MBI TË!)*, SHEMBULLI MË I LARTË I ASKETIZMIT

Asketizmi e zbukuronte Imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!)

Ka shumë transmetime që tregojnë për virtytet dhe cilësitë e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Si fillim, dua të theksoj se ajo që transmetohet për virtytet e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, nuk është e kufizuar vetëm te shi'itët. Me këtë nënkuptojmë se shi'itët nuk janë të vetmit që i transmetojnë ato, ose ndiejnë për të.[29]

Gjithashtu, shumë nga virtytet dhe cilësitë e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, transmetohen edhe në librat e jo shi'itëve. Janë të shumtë myslimanët që i duan, e respektojnë dhe e pasojnë Ehli Bejtin e Profetit të nderuar *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*, e sidomos Imamin e madh, Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Një nga transmetimet është nga Ibn El Megaziliji. Ai është shkrimtari i mirënjohur Shafi'i. Në librin e tij ai thotë se transmetuesi i këtij hadithi nuk është shi'it.

[29] Përjashtojmë vetëm një pakicë të vogël që numërohet me gishtat e dorës. Nuk dihet, nëse ka mbetur ndonjë shenjë prej tyre. Ndërsa pjesa tjetër e myslimanëve e duan dhe e nderojnë Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Transmetohet nga Enes bin Maliku, se i Dërguari i Allahut, *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Ali ibn Ebu Talibi do të ndriçojë në Xhenet për banorët e Xhenetit, ashtu sikurse zbardh dielli në mëngjes për banorët e tokës*".[30]

Kjo do të thotë se drita e tij është madhështore dhe mbizotëron në Xhenet, mbi të gjitha dritat e tjera.

I njëjti autor transmeton nga Amar ibn Jasiri: "*I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), i tha Ali bin Ebu Talibit (Paqja qoftë mbi të!): 'O Ali, Allahu të ka stolisur me një bukuri që nuk e ka zbukuruar asnjë nga krijesat e tij. Ajo është më e dashura tek Allahu dhe është asketizmi në këtë botë.*[31] *Ajo nënkupton mosdashjen dhe përbuzjen e kësaj bote, si dhe largimin nga ato shfaqje mashtruese që njeriut ia bëjnë të dashur dynjanë*".

Qëllimi këtu nuk është të rindërtojmë dynjanë dhe as të ringjallim tokën dhe ta stolisim me bukurinë hyjnore, në mënyrë që robtë e Allahut të përfitojnë prej saj. Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!),* ishte pararojë në këtë gjë. Ajo që nënkuptohet me dynja, është ajo që ju dhe ne kemi përgatitur për të, e asaj që ndodhet në tokë, për kënaqësitë e shpirtit, duke përfshirë këtu edhe ushqimin,

[30] Ibn El Gazali, "El Menakib", f. 140-185; edhe në burime të tjera; Sherhu El Akhbar ue el umdetu, ue el ikbal ue el bihar.
[31] El Muafak El Khauarizmi El Hanefi, "El Menakib", f. 113; Menakib El Megazilij, f. 105, me ndryshime të vogla.

edhe pijen, edhe varkën (makinë), si dhe dëshirat seksuale. Kjo është bota për të cilën flitet në këto transmetime. Është e natyrshme se përfitimi me masë të caktuar prej këtyre çështjeve është i lejuar, mbase mund të themi, edhe i pëlqyeshëm dhe i lavdërueshëm. Ajo që ne jemi të ndaluar të bëjmë, është zhytja në atë botë të ulët dhe të keqe.

Pra, asketizmi në këtë botë është stoli e Ali ibn Ebu Talibit *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Në pjesën tjetër të hadithit transmetohet nga i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* se i tha Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Vepro në atë mënyrë që dynjaja të mos marrë asgjë nga ti"*.

Transmetimi tjetër që ndriçon zemrat e atyre që e duan kaq shumë këtë personalitet të madh, është nga El Muafak El Khauarizmi El Hanefij, i cili gjithashtu, është një nga autorët e Ehli Sunetit dhe ka shkruar një libër mbi virtytet e Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Ne duhet të përgatitemi për të qenë pasues i kësaj figure madhështore, jo vetëm me emër, por edhe me vepra.

Nga El Muafak transmetohet se i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, i tha Aliut, *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"O Ali, unë i kërkova Zotit tim pesë cilësi dhe Ai m'i dha. Të parën që i kërkova Zotit ishte: Të ndajë tokën nga unë, të shkundë pluhurin nga koka ime dhe ti të ishe me mua. Ai ma plotësoi. Të dytën që unë i kërkova Zotit, ishte të*

qëndroj në njërën anë të peshores dhe ti të ishe me mua. Allahu ma plotësoi.

Të tretën që i kërkova Zotit, ishte: Të të bënte ty flamurtmbajtësin tim (mbajtësin e flamurit tim). Ai është flamuri i madh i Zotit. Nën të ndodhen të suksesshmit dhe fituesit e Xhenetit. Zoti ma dha mua.

(Nëpërmjet këtij hadithi Profetik tregohet qartë se në Ditën e Gjykimit do të ketë flamurmbajtës. Çdo grup krijesash do të jetë i tubuar në njërin nga këta flamurë.) *Sa për të katërtën, unë i kërkova Zotit tim që t'i jap për të pirë umetit tim nga burimi im. Ai ma plotësoi.*

E pesta: Unë i kërkova Zotin tim që të të bënte ty udhëheqësin e umetit tim në Xhenet. Ai ma dha. Domethënë, ti je në krye të umetit tim dhe do ta drejtosh atë për në Xhenet. Allahu e pranoi atë".

Pastaj e përfundoi rrëfimin duke thënë: "*Falënderimi i takon Allahut që ia mundësoi Aliut një gjë të tillë*".[32]

Nga këtu, ne shohim të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe familjen e tij, duke falënderuar Allahun për qëndrimin moral të Ali

[32] "El Menakib", f. 294.

ibn Ebu Talibit *(Paqja qoftë mbi të!)*. E vërteta është se askush tjetër nuk arrin në këtë pozitë.[33]

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), është maja e asketizmit

Përzgjodha një transmetim që është përcjellë në librin "El Irshad", nga dijetari El Mufijd. Tekstin e tij, unë e citova nga libri "Dyzetë Hadithet", nga Imam Khomeini *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, i cili është një libër shumë i rëndësishëm. Këtë hadith, unë e krahasova me atë që përmendet në librin "El Irshad".

Transmetuesi thotë: "Ne ishim tek Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!).* Aty u përmend Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!),* dhe ai e lavdëroi atë për atë që e meritonte".

Vërejta secilin nga paragrafët mbi të cilët bazohet hadithi. Ai shpreh dimensione të personalitetit të Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!),* siç është asketizmi, adhurimi i tij dhe cilësi të tjera që unë do t'i paraqes.

[33] Nga fjala e Imam Khameneit *(Allahu i dhëntë jetë të gjatë!)* në hytben e namazit të xhumasë, më 27.03.1992.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!),* sipas transmetimit, lavdëron Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*. Fjalia e parë që tha, është: *"Për Zotin, Ali ibn Ebu Talibi (Paqja qoftë mbi të!), kurrë nuk hëngri haram nga kjo botë, derisa shkoi në rrugën e tij (u largua nga kjo botë)"*.[34]

Ai nuk vuri në gojë një kafshatë haram. Ai iu shmang ngrënies së ushqimit haram dhe ngrënies së mallit haram, si dhe iu shmang pasurisë haram. Ai largohej edhe nga ajo që ishte e dyshimtë. Vëreni me kujdes, të pagabueshmit, i kanë qartësuar këto çështje si baza për çdo vepër, si model, si rregull, por më shumë në nivelin e mendimit dhe të kulturës. Imam Sadiku, Imam Bakiri dhe Imam Sexhadi *(Paqja qoftë mbi ta!)* kanë deklaruar se ata nuk mund ta përballojnë jetesën e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!),* kështu që imagjino sikur të vijë radha për dikë si puna ime? Mjerë për ne!

Këtu nuk po flasim, nëse mund të jetojmë unë dhe ti kështu. Jo, ai model është maja e jetës dhe Imami i referohet asaj. Referimi i atij modeli, nënkupton, që të gjithë duhet të ecin në këtë drejtim. Por, kush mund të arrijë majën? Në atë hadith, Imam Sexhadi *(Paqja qoftë mbi të!)* thotë: *"Unë nuk mund të jetoj dot ashtu"*.

[34] El Hurru El Amilij, "Uesailu Esh Shijati", vëll. 1, f. 68, K. "Istihbab el xhid ue el ixhtihad fi el ibadetu", Paragrafi 18.

Asketizëm që askush nuk mund t'i rezistojë

"Kur atij i afroheshin dy mundësi, të dyja këto janë të lejueshme nga Zoti, ai zgjidhte më të vështirën për veten e tij".

Pra, nëse atij i ofroheshim dy gjëra, që e kënaqnin Allahun, pra, jo se njëra prej tyre ishte e ndaluar dhe tjetra ishte e lejuar. Si për shembull, të jenë të dyja të lidhura me adhurimin, por njëra prej tyre është më e vështirë për trupin e tij se tjetra, ai do të zgjidhte të vështirën. Nëse do t'i ofroheshin dy lloje të ushqimit, ai do të zgjidhte ushqimin më të keq. Nëse do t'i ofroheshin dy lloje rrobash, ai do të zgjidhte më të keqen prej tyre. Nëse do t'i ofroheshin dy punë, të dyja hallall, ai do të zgjidhte më të vështirën për të.

Ky transmetim nuk është nga një njeri i zakonshëm, por përkundrazi, ai që e transmeton këtë, sikurse përcillet në transmetim, është Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*. Kjo do të thotë se fjalët e tij janë shumë të sakta. Vëreni me kujdes se si të qenit i rreptë me veten, është e rëndësishme në jetën e kësaj bote dhe kënaqësitë e saj.

"Gjithmonë që kam qëndruar me të Dërguarin e Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), ai lutej për mua dhe kishte besim tek unë".

Kur i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, haste ndonjë vështirësi, e thërriste dhe e delegonte atë gjithmonë në pararojë që ta

zgjidhte. Kjo është e para: Ai e dinte se ishte në gjendje ta kryente atë.

Së dyti: Ai nuk i shmangej punës së vështirë.

Së treti: Ai ishte i gatshëm për xhihad në Rrugën e Zotit.

Për shembull: Kur i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* migroi fshehurazi nga Meka në Medine, dikush duhet të flinte në shtratin e tij. I Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* shkoi tek Aliu. Edhe në luftëra, i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!),* gjithashtu, e dërgonte atë në pararojë.

Biseda këtu nuk trajtohet se unë dhe të tjerë të varfër dhe të dobët si puna ime, pretendojmë se duam të punojmë në këtë mënyrë. Jo, nuk është kështu, por çështja është që ne duhet të ecim në këtë drejtim. Njeriu mysliman që ndjek rrugën e Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!),* duhet të ndjekë këtë linjë dhe të ecë përpara sa më shpejt të jetë e mundur.

Më pas ai tha: "*Askush përveç tij nga ky umet, nuk mund t'i merrte përsipër detyrat që i ngarkonte i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ai punonte punën e një njeriu sikur fytyra e tij ndodhej midis Xhenetit dhe Xhehenemit*".

Domethënë, përkundër të gjitha këtyre veprave madhështore, frikës së tij ndaj Zotit dhe besimit të tij në Të, sjellja e tij ishte sjellja e një personi që jeton ndërmjet frikës dhe shpresës. Ai kishte frikë nga Zoti, sikur të lëkundej midis Xhenetit dhe Xhehenemit.

"*Ai shpresonte në shpërblimin e Xhenetit dhe i trembej ndëshkimit të Xhehenemit*".

Si përfundim të gjithë kësaj sa thamë më lart, mund të përmendim se me gjithë këtë xhihad, mundim, sakrificë dhe adhurim, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* nuk u mashtrua nga asgjë. Ndërsa nëse njëri nga ne fal dy rekate nafile, lexon disa lutje dhe derdh dy pika lot, ai goditet menjëherë nga mashtrimi. Po, dhe ai e imagjinon veten të fryrë si një pallua. Ndërsa Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, nuk u mashtrua nga punët e tij të mira, edhe pse ato ishin të shumta.

Përse frikësohen nga zjarri i Xhehenemit njerëz si i Dërguari i Allahut, Prijësi i besimtarëve dhe Imam Sexhadi *(Paqja qoftë mbi ta!)*? Ata kërkojnë strehim te Zoti i tyre. Allahu i Madhëruar e krijoi Xhenetin për njerëz si ata. Kjo i përket një studimi tjetër. Ne jemi njerëz të dobët. Horizonti ynë është i shkurtër. Nuk e kuptojmë Madhështinë e Zotit.

Shembulli ynë në këtë është si një fëmijë i vogël që luan para një personaliteti shkencor. Fëmija vjen dhe shkon, pa u kujdesur për ekzistencën e tij, sepse ai nuk e di kush

është. Ndërsa ju jeni prindi i atij fëmije, mendja e të cilit është njëqind herë më e madhe se ajo e fëmijës së tij. Tregohu i përulur dhe modest përballë këtij personaliteti. Kështu duhet të qëndrojmë ne përpara Zotit të Madhërishëm, sepse ne nuk e kuptojmë madhështinë e Tij.

Qofshin ata fëmijë, njerëz të pavëmendshëm, ose njerëz të thjeshtë. Sa u përket atyre që kanë kaluar nga grada e diturisë në gradën e besimit, nga grada e besimit në gradën e dëshmisë dhe nga grada e dëshmisë në gradën e shkrirjes te Zoti, u shfaqet madhështia e Zotit para syve në atë masë, saqë ata nuk i shohin veprat e mira që bëjnë. Ata thonë se nuk kemi bërë ndonjë punë. Ata e shohin veten se janë gjithmonë borxhlinj ndaj Krijuesit të Vetëm e Madhështor.

"Ai liroi nga robëria një mijë robër nga pasuria e tij, duke kërkuar kënaqësinë e Zotit dhe shpëtimin nga zjarri. Pasurinë e fitoi me duart e tij dhe djersën e ballit".

Pra, paratë që ai shpenzoi për lirimin e atyre robërve nuk i kishte të dhuruara, por përkundrazi, i kishte fituar me punën e duarve të tij, me djersën e ballit të tij dhe me sforco shumë të madhe.

Ai punonte, jo vetëm gjatë periudhës së të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, por edhe gjatë njëzet e pesë viteve pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut, madje edhe gjatë periudhës së kalifatit të tij. Ekzistojnë argumente dhe prova se ai punonte në

periudhën e kalifatit të tij. Ai gërmonte kanale, punonte toka dhe i ujiste ato. Ai fitonte para në këtë rrugë, pastaj i shpenzonte ato për hir të Zotit. Blinte skllevër dhe i linte të lirë. Në këtë mënyrë ai liroi nga skllavëria një mijë skllevër.

"*Ai e ushqente familjen e tij me vaj, uthull dhe hurma*". Kjo do të thotë se ushqimi i zakonshëm, në shtëpinë e tij, ishte vaji, uthulla dhe hurma të llojeve të mesme, ose të llojit më të ulët. Ushqimi i tij, nëse do ta krahasosh me ushqimin e sotëm, ngjante si buka me kos, ose buka me djathë.

Rrobat që ai vishte, nuk ishin gjë tjetër veçse rroba të leshta (krabis). Nëse diçka ishte më e gjatë se dora e tij, ai e shkurtonte atë. Kjo do të thotë se, ai nuk ishte i kënaqur dhe nuk e lejonte as veten e tij që t'i mbante mëngët e gjata. Nëse pëlhura ishte e gjatë, ai merrte gërshërët dhe e shkurtonte atë. Ai nuk pranonte që mëngët e këmishës së tij të ishin të gjata dhe thoshte: "*Kjo është tepricë, le ta përdorë rrobaqepësi për të qepur diçka tjetër*".

Pëlhura në atë periudhë ishte e paktë. Njerëzit vuanin për ta marrë dhe për ta përdorur atë. Një copë e vogël pëlhure të jetë e nevojshme që të përdoret dhe të përfitohet prej saj.

Pastaj ai foli për adhurimin e tij. Ai ishte maja e Islamit dhe modeli që myslimanët e merrnin për shembull. Është përcjellë në këtë transmetim: "*Askush nuk i përngjan*

atij më së shumti, as nga fëmija e tij dhe as nga familjarët e familjes së tij, në veshje dhe botëkuptim e tij, sesa Ali ibn Hysejni".

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*Askush nga anëtarët e familjes së tij nuk i ngjante Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), në sjelljen, asketizmin dhe adhurimin e tij, përveç Imam Sexhadit (Paqja qoftë mbi të!)*".[35]

Mielli i ashpër, një mësim për guvernatorin

Përcillet se Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, dëshironte të caktonte një njeri nga Thekijfi, si guvernator në një rajon.[36] Ai i tha: "*Nesër në mesditë, pas faljes së namazit të drekës, eja tek unë*".

Është praktikë e zakonshme në kohën tonë se, kur caktohet një guvernator, ose zyrtar, që udhëheqësi ta thërrasë atë për ta informuar dhe për t'i dhënë rekomandimet e tij. Ky person thotë: "U ktheva tek ai në kohën e caktuar dhe nuk vërejta që ai të mbante një sekretar për të më pritur.

E gjeta atë të ulur. Pranë kishte një enë me ujë. Më kërkoi të merrja një enë të ngushtë, të vulosur. Mendova me vete: 'Ai ka aq shumë besim tek unë, sa po me tregon edhe

[35] Nga fjala e Imam Khameneit *(Allahu i dhëntë jetë të gjatë!)* në namazin e xhumasë, në Teheran, më 31.12.1999.
[36] Është rajoni i Akiras.

bizhuteritë'. E theu vulën dhe e hapi. Brenda në të kishte miell të ashpër. E nxori dhe e derdhi në enë dhe mbi të shtoi ujë. Piu prej saj dhe më dha dhe mua të pija. Nuk m'u durua dhe i thashë: 'O Prijësi i besimtarëve! A e përgatit këtë ushqim në Irak, kur aty, sikurse e sheh ka shumëllojshmëri ushqimi?'

Ai më tha: *'Pasha Allahun, unë nuk e vulos atë nga koprracia, si dhe nuk frikësohem se dikush do të ma hajë këtë miell të lirë, por unë blej dhe konsumoj aq sa më nevojitet nga ky miell, që është nga më të lirët. Unë frikësohem se mos dikush tjetër shton në të përveç miellit që unë blej. E urrej të fut në bark diçka tjetër, përveç të mirës. Dua të ha ushqim të mirë, të cilin e blej me paratë e mia dhe ato para i kam fituar me djersë dhe hallall.'"* .[37]

Kur Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!),* donte ta mësonte këtë guvernator, ai e thirri atë për t'i treguar këtë skenë dhe për t'i thënë këtë hadith. Ai ishte në gjendje ta këshillonte në xhami, por e solli në shtëpi, që t'i linte të kuptonte dhe t'i thoshte se ju do të udhëhiqni një qytet. Nën komandën tuaj do të keni shumë njerëz. Për këtë arsye ju duhet t'i kushtoni vëmendje taksave të tyre, pasurive të tyre, nderit të tyre, si dhe shpirtrave të tyre. Kjo nuk është fuqi absolute. Kështu që të jesh guvernator, nuk do të thotë që je i lirë të veprosh si të duash, prandaj gjithmonë mendoje se çfarë po bën.

[37] El Al'lametu El Mexhlisij, "Biharul Enuar", vëll. 40, f. 355, K. "Zuhdul Imam Ali, tak'uahu, ue ueruhu", Hadithi 15.

Më pas ai i tha: *"Tregohu i kujdesshëm në ushqimin që ha"*. Ushqehu, por mos mendo vetëm për ushqimin.

Kjo është jeta e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe ky është mësimi nga asketizmi i tij.

Veshja e tij e hollë, në të ftohtin e acartë

Harun ibn Antaretu[38] transmeton një ngjarje nga babai i tij: "Kur unë hyra tek Ali ibn Ebu Talibi *(Paqja qoftë mbi të!),* ai po dridhej nga të ftohtët. Imami ishte ulur në dhé. Ishte veshur hollë dhe dridhej. Unë i thashë: 'O Prijësi i besimtarëve! Allahu i Plotfuqishëm ty dhe familjes tënde i ka dhënë pasuri të mjaftueshme. Ju mund të veproni për vetë si të dëshironi. O Prijësi i besimtarëve, përse dridhesh në këtë kohë të ftohtë? Vish diçka'.

Ai m'u përgjigj: '*Për Zotin, unë nuk do të marr asgjë nga pasuria juaj. Kjo që kam veshur, është veshja që dola në rrugë nga shtëpia ime nga Medina. Nuk kam me vete asgjë tjetër veç saj*'".[39]

Kjo ishte gjendja e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*. Ai ishte në krye të pushtetit. Ne jemi

[38] Ai është Harun ibn Antaretu. Ngjarjen e transmeton nga babai i tij që e ka parë në një nga betejat.
[39] "Biharul Enuar", vëll. 40, K. "Zuhd Imam Ali, takuahu, ue ueruhu", Hadithi 15, f. 334.

katër ose pesë mijë metra më poshtë se ai, prandaj duhet të ecim dhe të shkojmë drejt tij.

Ky është mësimi që na dha ne Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*. Në të vërtetë, sa herë që shohim jetën e këtij kolosi, ne marrim këshilla dhe mësime.[40]

Ky është asketizmi i Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, në të gjitha drejtimet e jetës së tij.[41]

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ishte njeriu më prodhues dhe më asket

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, ishte shembulli më i lartë i asketizmit. Asketizmi është një nga temat më të spikatura në veprën "Nehxhul Balaga". Sidoqoftë, ai, përgjatë njëzet e pesë viteve nga vdekja e të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe derisa u zgjodh kalif, shpenzonte nga pasuria e tij personale për bamirësi të ndryshme. Ai kultivonte pemë. Krijonte ferma, hapte puse, hapte kanale vaditjeje në fusha etj. Është për t'u habitur që ai i jepte lëmoshë të gjitha ato, për të fituar kënaqësinë e Zotit.

[40] "Hadijthul Uilajeti" (meusuatu Khitabatul Kaid), vëll. 7, f. 40-55.
[41] Fjala e udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 05.04.1991.

Nuk ka dyshim se Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!),* ishte më produktivi i njerëzve. Është përcjellë se ai ka thënë: "*Bamirësia ime sot, nëse do t'i shpërndahej Beni Hashimëve, do t'u mjaftonte atyre*".[42]

Kështu ishte produktiviteti i tij. Por ky njeri i pasur jetonte jetën më të varfër, sepse e shpërndante tërë atë pasuri në Rrugën e Zotit. Ai gërmonte puse me duart e tij. I kryente vetë të gjitha punët.

Transmetuesi tregon: "Pashë një pus që i derdhej uji si gunga e devesë. Prej tij doli Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!),* i mbuluar me baltë. U ul në buzë të tij. Ai kërkoi një letër dhe shkroi në të se ky pus është vakëf nga Ali ibn Ebi Talib për njerëzit që përmendi.

Koha e qeverisjes së Prijësit të besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!),* ishte zgjatim i jetës së tij private dhe karrierës së tij (para kësaj), e cila, gjithashtu, u shfaq gjatë udhëheqjes të tij.

Asketizmi në këtë botë nuk është në kundërshtim me ndërtimin e saj, të cilin Zoti e bëri detyrë për të gjithë. Ndërtojeni botën, ringjallni tokën dhe krijoni pasuri. Por, mos u ngjitni dhe u jepni pas saj, mos u bëni skllevër të saj dhe mos jini robër të parave dhe pasurisë, në mënyrë që ta shpenzoni pasurinë më lehtë në Rrugën e Zotit.

[42] Ibnu Taus, "Keshful Muhexhet"i, f. 124.

Ky është ekuilibri islam. Shembuj të këtij lloji ka shumë. Nëse do të doja të jepja shembuj të tyre, do të duhej shumë më tepër kohë.[43]

[43] Fjala e udhëheqësit në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 31.01.1997.

KAPITULLI I KATËRT

ASKETIZMI ËSHTË KULTURË DHE KURË SHËRUESE

Lum ata që janë gjithmonë në namaz!

Kur kryeni adhurimet dhe lexoni lutje e dua me besim të plotë shpirtëror, e kryeni namazin me frikë dhe ndjenjë në zemër, ose shpenzoni për një person që e ka merituar, atëherë do të shihni se çfarë kënaqësie keni përfituar dhe se çfarë suksesi keni arritur. Kjo kënaqësi nuk mund të perceptohet dhe të shijohet nga ushqimi. Besimtari e shijon ëmbëlsinë e adhurimit gjatë jetës së tij, kohë pas kohe, në momente dhe në përmasa të ndryshme ndërmjet një personi dhe një tjetri. Ai është i gatshëm të heqë dorë nga dynjaja dhe çfarë ka në të, në mënyrë që kjo kënaqësi të mbetet përherë tek ai, që ai ta ndiejë dhe ta përjetojë në momentin që i drejtohet Zotit, në adhurimin dhe në lutjen që i bën Atij, duke qarë nga frika e Tij.

Është e natyrshme që materialja e nxjerr njeriun nga ato gjendje që ndodhin ndonjëherë tek ai, domethënë gjendje të kënaqësisë shpirtërore. Ata që nuk e njohin Zotin dhe qëllimet shpirtërore, nuk e shijojnë ndjenjën e kësaj kënaqësie. Janë të shumtë ata njerëz që e kanë kaluar jetën e tyre nën sistemet e mallkuara materialiste. Ata nuk e kanë pasur mundësinë ta shijojnë ndjenjën e kthimit te Zoti dhe kënaqësinë shpirtërore, qoftë edhe për një moment të vetëm. Ata nuk e kuptojnë se çfarë po themi.

Islami dëshiron t'i ngrejë njerëzit në një nivel të lartë, të ndriçojë zemrat në një masë të caktuar, të largojë mëkatet nga gjokset tona, në mënyrë që ne të arrijmë të shijojmë gjendjen e kënaqësisë shpirtërore në të gjitha momentet e jetës sonë. Këtë ta arrijmë jo vetëm në faltoren e adhurimit, por, përkundrazi, ta ndiejmë edhe në mjedisin e punës dhe gjatë studimit, në fushën e luftës, gjatë mësimmarrjes dhe mësimdhënies, dhe në arenën e rindërtimit.

Lum ata që e falin gjithmonë namazin! Kjo do të thotë se ata janë me Zotin gjatë tregtisë së tyre, janë me Zotin gjatë ngrënies dhe pirjes. Ata e ndiejnë dritën jo vetëm në mjedisin e tyre dhe përreth saj, por në të gjithë botën. Nëse kjo dynja mund të edukojë këta lloj njerëzish, atëherë do të çrrënjoset burimi i luftërave, i padrejtësisë, i diskriminimit dhe i urrejtjes. Kjo është jeta e mirë dhe e këndshme.

Çfarë nënkupton një jetë e mirë dhe e këndshme?

Një jetë e mirë, nuk do të thotë që një person të kryejë namazin dhe adhurimet e tij dhe të mos kërkojë të përzihet aspak me materialen dhe çështjet e jetës. Jeta e mirë nënkupton bashkimin e kësaj bote (dynjasë) dhe Ahiretit (Botës Tjetër). Një jetë e mirë bashkon shpirtin dhe materien. Një jetë e mirë nënkupton një komb që përpiqet të ndërtojë dhe të ngrejë industrinë, tregtinë dhe bujqësinë në nivelet më të larta. Ai ka aftësi shkencore dhe teknike në fusha të

ndryshme. Në të gjitha këto raste, zemra e tij është me Zotin. Ai e njeh Zotin çdo ditë e më shumë.

Ky është qëllimi i sistemit islam. Ky është qëllimi i ndjekur nga Profetët *(Paqja qoftë mbi ta!)* dhe të cilin e kanë shpallur reformatorët e botës. Në të kanë ftuar dhe kanë thirrur personalitetet e mëdha islame gjatë njëqind e pesëdhjetë deri në dyqind vitet e fundit.[44]

Asketizmi, çështja më e madhe që është trajtuar në veprën "Nehxhul Balaga"

Kur Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!),* foli për asketizmin, i referohej asaj si një ilaç bazë për të trajtuar plagën e bashkësisë islame. Unë, gjithashtu, e kam thënë në mënyrë të përsëritur se ne sot kemi nevojë të recitojmë ajete të asketizmit. Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!),* kur flet për këtë kohë, thotë: "*Bëni kujdes të mos ju tërheqin kënaqësitë dhe ëmbëlsitë e kësaj bote. Qëllimi nuk është për ata që nuk i arrijnë kënaqësitë e kësaj bote, sepse ata janë të shumtë*".

Hadithet e tij ishin për ata që kontribuuan në çlirimet islame. Ata dhanë kontribut me vite të tëra në përhapjen e

[44] Biseda e Imam Khameneit *(Allahu i dhëntë jetë të gjatë!)* në tubimin e banorëve të qytetit të Meshhedit dhe vizitorëve të Imam Err Rridas *(Paqja qoftë mbi të!)*, më 18.04.1991.

perandorisë islame në botë dhe u mundësuan atyre të fitojnë privilegje. Ishin ata që u tërhoqi vërejtjen Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Gradat e asketizmit, në të lejuarën (hallall) dhe të ndaluarën (haram)

Sot, do të themi dy fjalë për asketizmin. Duhet t'i kushtoni vëmendje. Disa prej tyre thonë se udhëheqësi ynë, shumica e njerëzve nuk kanë atë që ju i këshilloni. Përgjigjja është: Ne nuk u themi atyre që s'munden, por u themi atyre që e kanë mundësinë. Atyre që u janë mundësuar kënaqësitë e dynjasë. Ata që kanë mundësinë, që përmes të ndaluarës (haramit), të shijojnë ëmbëlsinë dhe kënaqësitë e jetës. Sigurisht që, gjithashtu, i drejtohemi dhe i themi gradës së dytë, atyre që mund të kenë qasje në këto kënaqësi përmes të lejuarës (hallallit).

Sigurisht, shmangia e të ndaluarës (haramit) është nga domosdoshmëritë e asketizmit dhe arritja e niveleve të tij të larta: devotshmërisë, ruajtjes së të fshehtës, si dhe pastërtisë shpirtërore. Ndërsa asketizmi në kënaqësitë e lejueshme, është një pozitë sublime. Natyrisht, që ky fjalim do të jetë për grup të vogël. Periudha e tanishme është si ato ditë, me ndryshimin e rrethanave të kohës dhe veçoritë historike që lidhen me secilën fazë. Ata që e kanë mundësinë dhe që mund të arrijnë mirësitë, kënaqësitë, mirëqenien dhe

mund të grumbullojnë para dhe pasuri, duhet të kujtojnë fjalimet asketike të Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Natyrisht, që kjo çështje u drejtohet zyrtarëve. Për ta është e rëndë dhe më e vështirë, sesa për ata që nuk kanë përgjegjësi qeveritare. I njëjti ligjërim vlen dhe u drejtohet edhe atyre, por në një masë më të vogël.

Transformimi i asketizmit në kulturë

Nëse shoqëria jonë islame, e cila po përballet me gjithë këto rreziqe dhe gjithë këta armiq, është në gjendje t'u kushtojë vëmendje dhe kujdes të madh këtyre çështjeve dhe t'i shndërrojë ato në kulturë, në mënyrë që të gjithë jo vetëm ta vërejnë dhe të flasin për të, por edhe ta kërkojnë atë. Në këtë rast, zbatimi i drejtësisë dhe ky asketizëm, nuk do ta dobësojë sistemin islam. Ai përçon tek ai më shumë fuqi. E forcon sistemin islam dhe e imunizon atë nga dëmet.

Njerëzit që nuk mashtrohen nga kënaqësitë, ambiciet dhe dëshirat e kësaj bote, si dhe ata që nuk e harrojnë vetveten, janë në gjendje të qëndrojnë përballë armiqve dhe kundër armiqësive. Ata mund ta shpëtojnë shoqërinë dhe sistemin në një moment rreziku, përkundrejt të gjithë këtyre armiqësive me sistemin islam.

Përgjegjësia është e madhe për të gjithë. Veçanërisht ajo është e madhe për të rinjtë, zyrtarët, studiuesit si dhe ata që njerëzit i shikojnë si modele dhe shembuj për t'u ndjekur.

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, i ndezi këta dy pishtarë, për të ndriçuar me ta tërë historinë. Ai vazhdon ta ndriçojë atë. Nëse disa njerëz devijojnë, ata janë të humbur. Emri dhe mësimet e Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* nuk do të harrohen. Ato do të mbeten gjithmonë në histori.[45]

Asketizmi, dera e lartësimit shpirtëror

Është e sigurt se një nga faktorët e lartësimit në Islam, është besimi në Zot dhe zbatimi i dispozitave të Allahut. Në Kur'an thuhet: **"I Dërguari beson në atë** (Kur'anin) **që i është shpallur nga Zoti i tij e po ashtu dhe besimtarët: të gjithë besojnë në Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe të Dërguarit e Tij"**.[46]

Ishte i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe myslimanët e ditëve të para që besuan në Islam me thellësitë e zemrave të tyre. Ata besuan thellësisht në Islam, në shpëtim. Besuan në parullat

[45] Fjala e udhëheqësit, me përfaqësuesit e popullit, më 25.11.1996.
[46] Sure "El Bekare", ajeti 285.

dhe të vërtetat islame. Ky besim ishte një faktor shumë i rëndësishëm.

Ndër faktorët e tjerë, ishte ai që, më së paku, qëndronte në krye të kësaj lëvizjeje. Është sinqeriteti i një personi për atë që lidhet me personin tjetër dhe përfitimet e tij materiale i vijnë prej kësaj lidhje. Ky është një faktor shumë i rëndësishëm.

Gjithçka që kemi nga transmetimet, në veprën "Nehxhul Balaga" dhe nga hadithet fisnike të Profetit më të Nderuar *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe Imamët *(Paqja qoftë mbi ta!),* si dhe këshillat e kolosëve të mëdhenj, për t'u larguar nga dynjaja dhe për të mos u kapur pas zbukurimeve të saj, është për shkak të ndikimit të madh të këtij faktori.

Është e sigurt se armiqtë e Islamit dhe ata që kanë perceptime të gabuara në mesin e myslimanëve, besojnë, ose imagjinojnë se qëllimi me asketizëm në Islam është të mos pasosh dhe të mos ndjekësh kënaqësitë e jetës. Ndërkohë që çështja nuk është e tillë. Ajo që synohet, është bota e dënueshme. E dënueshme është që qëllimi i lëvizjes sonë të jetë përfitimi personal dhe të rendim pas tyre. Kjo gjë është shkatërruese dhe baza e mjerimit.

Të dashurit e Zotit ishin në gjendje ta mbanin lart këtë flamur. Ata ecën në rrugën e vështirë, pa lodhje dhe mërzi. Ishin njerëz që e kaluan këtë provë.

Kjo është arsyeja pse ne shohim në fillim të Lutjes "En Nudbetu" këto fjalë: "Falënderimi i takon Allahut për bekimin e të dashurit e Tij".

Një nga ato koncepte, ndër më të bukurit dhe më të thellët, është përfshirë në fjalitë e para të lutjes: "Pasi kushtëzove mbi ta asketizmin në shkallët e kësaj bote të ulët, zbukurimin e saj dhe zenitin e saj, i ngrite ata në lartësitë më të larta të përsosjes. Këto begati nuk do të zhduken dhe nuk do të pakësohen. Por, Ti vendose për ta një kusht, kështu që pozita e të Dërguarit është në nivelin më të lartë të ekzistencës njerëzore.

Kjo çështje nuk mund të realizohet pa ndihmën hyjnore dhe pa përshtatje dhe përgatitje nga Zoti i Plotfuqishëm. Kjo pozitë është në këmbim të një kushti specifik të parashtruar nga Allahu i Madhërishëm: "Asketizëm në gradët e kësaj bote të ulët, në stolitë dhe në zenitin e saj".

Ata e mbajtën këtë kusht. E si rrjedhojë e pranimit të këtij kushti, ishte prania e njerëzve si Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe si Prijësi i besimtarëve. Personalitete, që kanë vullnet dhe këmbëngulje të thellë, çka i mundëson ata të marrin përgjegjësi dhe të krijojnë dinamizëm që nuk mbaron me fundin e jetës së tyre.

Kjo është një lëvizje e vazhdueshme. Ju mund ta vini re, se edhe pas kalimit të katërmbëdhjetë shekujve, Islami po shkëlqen. Gjithçka vërtitet rreth të njëjtës ekzistencë të bekuar dhe sakrificës së saj. Kjo i dha kësaj lëvizje këtë vazhdimësi. Gjithashtu, ndihmoi atë kontribut që dhanë myslimanët, besimtarët dhe kolosët përgjatë rrugëtimit.[47]

[47] Fjala e Imam Khameneit *(Allahu i dhëntë jetë të gjatë!)* në takim me zyrtarët qeveritarë, më 06.11.1996.

KAPITULLI I PESTË

NJË FJALË PËR BURRAT QË I KANË ZEMRAT E LIDHURA ME ZOTIN DHE QËNDROJNË TË PALËKUNDUR NË RRUGËN E TIJ

Ju dhe familjet tuaja të pastra jeni model dhe shembull

Nuk duhet të lejojmë që luksi, rehatia dhe kënaqësitë të na largojnë nga falënderimi i Allahut të Madhëruar dhe nga mjedisi i (njerëzve të Zotit). Nuk duhet të lejojmë të ndikojnë me asnjë lloj shkaku tek ai grup i pastër dhe vetëmohues. Nuk duhet të lejojmë që vendosmëria e kërkuesve të së vërtetës të tronditet nga vesveset. Ju dhe familjet tuaja të pastra e sakrifikuese, e kanë merituar të jenë model dhe shembull që duhet të ndiqen nga ata që ju kanë shërbyer dhe ju kanë dashur. Për këtë shkak ju duhet ta ruani këtë mirësjellje.

Pa dyshim që shfaqjet e pavlera nuk do të jenë në gjendje të rrëzojnë në gropë kolosët e palëkundur, ata burra që e duan Zotin. Nuk mund të zëvendësohen vlerat origjinale me vlera tradicionale dhe boshe.[48]

[48] Mesazhi i Imam Khameneit *(Allahu i dhëntë jetë të gjatë!),* në kongresin e katërt të udhëheqësve, drejtorëve dhe zyrtarëve të gardës, më 16.09.1991.

Armiku punon për të shkatërruar strukturën islame

Unë kam një ndjenjë të brendshme që plani themelor i armiqve tanë, është shkatërrimi i strukturës së Republikës Islamike të Iranit. Ky është misioni i tyre bazë.

Ata nuk do të jenë në gjendje të bëjnë asgjë, për sa kohë që ky formacion, me këtë strukturë dhe këto elemente të afta, të jetë i pranishëm dhe të ekzistojë brenda sistemit në formën e tij të natyrshme. Nëse ata duan ballafaqim dhe kundërshtim, atëherë zgjidhja e vetme është planifikimi për të shpërbërë këtë strukturë.

Nëse ata do të ishin në gjendje ta bënin këtë, me presionet politike, për çështje të tilla si çështja e energjisë bërthamore, ata mund të përmbysnin regjimin nëpërmjet një sulmi ushtarak, jo në shkallë të gjerë, por në mënyrën tradicionale (grusht shteti). E gjithë kjo do të ndodhte, nëse do të ishin në gjendje ta shkatërronin këtë infrastrukturë themelore.

Nëse nuk janë në gjendje ta dobësojnë dhe ta shpërbëjnë këtë strukturë si dhe forcat që e përbëjnë atë, atëherë asnjë presion, ose forcë nuk do të jetë në gjendje ta shkatërrojë dhe ta nënshtrojë regjimin.

Shpërbërje kulturore, kjo është sfida

Cila është rruga që ndjekin armiqtë dhe kërkojnë të dobësojnë strukturën e Republikës Islamike? Në të vërtetë, çfarë janë duke vepruar ata për ta bërë Republikën Islamike të humbasë strukturën e saj themelore?

Katër janë shtyllat kryesore që ata ndjekin. Natyrisht kanë shumë degë dhe nën degë, të cilat formojnë dispozitat themelore të aktivitetit së tyre:

1- Shpërbërja kulturore.

2- Presionet e vazhdueshme ekonomike.

3- Krijimi i formacioneve politike dhe shoqërore brenda shtetit të cilat i nënshtrohen dhe i binden ndikimit të armikut.

4- Prishja e njerëzve të aftë dhe efektivë të sistemit.

Shpërbërja kulturore nuk është një punë që armiqtë mund ta kryejnë me lehtësi. Ekziston një luftë kulturore. Unë e kam thënë vite më parë, ndërsa tani të gjithë e pranojnë këtë çështje. Por, luftë nuk do të thotë domosdoshmërisht fitore në të. Pa dyshim, ne kemi qenë objekt i goditjeve të shumta nga armiqtë në fushën e luftës kulturore. Kjo luftë ka qenë shkak i krijimit të lëvizjeve dhe

aktiviteteve që nuk do të shfaqeshin në qarqet elitare dhe në arenat universitare, po të mos ishte vigjilenca dhe vetëdija për ekzistencën e kësaj lufte.

Prandaj, armiku mund të sulmojë, por krijimi i shthurjes kulturore në sistemin e Republikës Islamike është një punë jashtëzakonisht e vështirë. Ky është qëllimi i armikut. Ai kërkon ta arrijë atë. Investon aftësitë dhe mundësitë e tij me bujari dhe pa turp për të arritur qëllimin. Shpenzon para dhe pasuri duke shpresuar se ai mund të arrijë sukses në këtë aktivitet.

Këto katër tema që përmendëm më sipër, secila prej tyre, veç e veç, u shkakton armiqve të Republikës Islamike shumë ngarkesë dhe probleme, por ata përpiqen t'i realizojnë ato.

Nga ana tjetër, ne duhet të përballemi në të gjitha këto fronte. Ne po e bëjmë atë. Po shpenzohen shumë energji dhe përpjekje të mira, të vendosura në gjithë këto fronte, për t'u përballur me përpjekjet e armikut dhe duke i neutralizuar ato.

Dashuria për dynjanë dëmton historinë e Islamit

Fuqitë e mëdha kanë ndërhyrë politikisht dhe ushtarakisht përgjatë historisë dhe kanë ndikuar në fatin e dhjetëra miliona njerëzve në rajonin e Lindjes së Mesme. Ky

ndikim ka sjellë pasojat e tij në një mënyrë apo në një tjetër në të gjithë botën.

Një nga pengesat më të mëdha në këtë rajon, është fryma e rilindjes islame. Irani është bërthama dhe qendra e saj.

Secili prej nesh duhet ta kuptojë sot këtë çështje. Duhet ta dimë se dorëzimi ynë kundrejt pasioneve shpirtërore, ndjekja e kënaqësive të kësaj bote, luksit dhe kënaqësive të ulëta dhe të ndyra, nuk do të thotë që një person humbet vetëm identitetin e tij, por që ne të kontribuojmë, sipas ndikimit së secilit prej nesh, në humbjen e botës islame, humbjen e këtij rajoni të madh të botës dhe, si pasojë, ne do të humbasim historinë e Islamit. Për këtë arsye ne duhet t'i kushtojmë vëmendje të madhe kësaj çështjeje.

Mos lejoni që garda të preket nga humbja e motivimit. Mos lejoni që nga garda të largohet shpirti revolucionar dhe fetar, që formojnë përbërësit e saj themelorë. Sipas mendimit tim, kjo është një nga përgjegjësitë dhe detyrat më të rëndësishme që u janë besuar zyrtarëve të gardës.

Mos u përzieni me përfitime dhe interesa personale

Ekstravaganca brenda organizmit të gardës nuk është aspak e dëshirueshme. Po kështu, edhe përfitimi personal i udhëheqësve është i papranueshëm. Përfitimi dhe interesi personal janë çështje që hidhen poshtë plotësisht. Kini kujdes që të mos përfshiheni, duhet të shmangni ndotjen.

Dëgjimi i këtyre frazave mund të jetë i vështirë për disa veshë. Shkaku është se ata i shohin njerëzit nga ana e përfitimit personal, duke lënë nderin e tyre dhe gjithçka tjetër. Ata ulin personalitetin e tyre dhe të gjitha përpjekjet e tyre intelektuale dhe praktike për të marrë një përfitim të neveritshëm material. Në fakt, kjo çështje ka shumë përbuzje prej myslimanit, muxhahidit dhe personit të rezistencës. Kjo është ajo që bënë banorët e kësaj dynjaje gjatë gjithë historisë. Ata përfituan pak prej saj, pastaj u larguan dhe e lanë gjithçka këtu.

Sa për njerëzit që kanë ide të larta, si dhe kanë shpresë të madhe te Allahu, ata u nderuan me xhihad në Rrugën e Zotit. U nderuan me pjesëmarrjen në revolucionin më të rëndësishëm që mban flamurin e Islamit në këtë periudhë. Është e turpshme që, pasi kanë kaluar gjithë këto vite, ata të ndjekin rrugën e gabuar (shtrembër) që e pasojnë ata që e kërkojnë këtë botë dhe të fiksuarit pas saj.

Krenari (lavdi) është kur shihni disa njerëz që luftojnë mbi kufomat e kësaj bote, ndërsa ata mundohen të mohojnë të gjitha argumentet për shkak të saj. Ju qëndroni dhe i shikoni me përbuzje këto kufoma dhe mbroheni nga ndotja e tyre. Kjo është lavdia. Kjo është ajo që kërkon shpërblimin hyjnor. Ajo trashëgon krenarinë e kësaj bote dhe të Botës Tjetër (Ahiretit). Meriton lavdërimin e engjëjve. Kjo është ajo që duhet të kërkohet dhe të punohet për të.

Ajo që ka vlerë në këtë çështje

Sidoqoftë, unë duhet t'ju them, gjithashtu, se ndonjëherë një person nuk e kupton dhe nuk e vëren se po lëviz në një rrugë të gabuar. Për këtë arsye ai duhet të këshillohet, të paralajmërohet dhe të bisedohet me të.

Kur themi ekstravagancë, shumë do të thonë: Jo, falënderimi i takon Allahut, ne nuk e kërkojmë atë, por ata në fakt nuk po bëjnë kthesë. Nëse shqyrtojmë me vëmendje natyrën e jetës së tyre, mund të vërejmë shenja dhe modele që tregojnë një gabim të tillë, si dhe një të metë në jetën e tyre. Ndërsa vetë personi nuk është në dijeni të kësaj.

Ky lloj i gabimeve dhe i dështimeve në të cilat bie një person, nuk i shfaq shpejt ndikimet e tij. Në këtë mënyrë, ata janë të pavetëdijshëm në atë që bëjnë dhe në gabimin ku kanë rënë.

Në çdo rast, ne i kërkojmë dhe i lutemi Zotit që të na mbrojë dhe të na ruajë nga rrëshqitja në grackat ku kanë rënë shumë njerëz.

Bëni kujdes dhe mbroni gardën dhe aftësitë e saj morale. Kjo aftësi morale realizohet duke ruajtur shpirtëroren, mbi bazën e të cilës u krijua garda. Vetëm atëherë lidhja me kampin e Hysejn ibn Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, bëhet një lidhje reale. Cilësia dhe vlera e lidhjes suaj me Prijësin e dëshmorëve është edhe më shumë reale dhe krenare, sesa përkatësia e fëmijëve të atij njeriu kolos. Janë të shumtë ata që kanë qenë fëmijë të vërtetë të atyre njerëzve madhështorë. Por ata nuk e njihnin të drejtën e tyre dhe nganjëherë ata ngrinin shpatën në fytyrë të tyre, ose lëviznin kundër lëvizjes së tyre.

E lus Allahun e Madhëruar që t'u japë sukses të gjithëve.[49]

[49] Fjala e udhëheqësit të revolucionit, Imam Khameneit *(Allahu i dhëntë jetë të gjatë!)*, në kongresin vjetor me udhëheqësit dhe oficerët e gardës së Revolucionit Islamik, më 18.09.2004.

Kujdesuni për zemrat tuaja dhe për zemrat e atyre që janë me ju

E vetmja shpresë që kanë këta armiq, është të mbjellin dyshime në zemrat e njerëzve për këto koncepte dhe parime. Por, para se t'i mbjellin në zemrat e njerëzve, i mbjellin në zemrat e zyrtarëve të tyre.

Regjimi që pretendon se udhëheq botën tani, ka Amerikën që qëndron në krye të tij. Prej tij buron vetëm padrejtësi, gjakderdhje, humbje të të drejtave, diskriminim dhe aktet e dhunës së pashoqe. Ai nuk mund të provojë vetveten me asgjë tjetër dhe nuk mund të gjejë besim në zemrën e askujt. Atyre u mungojnë argumentet. Ata po përpiqen që përmes medias dhe ryshfetit, të blejnë ndërgjegjen dhe gjithçka tjetër. Këtë e bëjnë për të destabilizuar nga brenda regjimin Islam. Duhet të kihet kujdes kundrejt kësaj. Kjo nuk është e veçantë vetëm për ju, por na përfshin të gjithëve ne. Secili prej nesh duhet të kujdeset për zemrën e tij, në radhë të parë dhe pastaj për zemrat e atyre që e rrethojnë dhe që janë të lidhur me të.

Një jetë e qetë dhe me luks krijon dyshime

Zemrat që janë të mbushura me besim, largpamësi dhe dituri, nuk nënshtrohen kurrë dhe nuk e njohin frikën.

Për sa u përket atyre (armiqve), së pari, për ta është e nevojshme që të mbjellin dyshime në zemrat e tyre, në mënyrë që të përhapin frikë, disfatizëm dhe nënshtrim. Ky dyshim nuk përhapet gjithmonë përmes mendjes. Ndonjëherë merret përmes trupit: dëshirat, pasionet fizike dhe dashuria për pasuri, "pasuria sprovuese". Lutjen e përcjellë në Sahifen Sexhadije: "O Zot mbroji myslimanët nga përçarja!", shumë nga të rinjtë tanë e lexonin në front.

Transmetohet se ajo pastron zemrën nga rreziku i pasurisë sprovuese[50], nga kërkimi i pozitës, i luksit dhe i jetës së shthurur. Të gjitha këto mbjellin dyshime në zemrën dhe mendjen e njeriut përmes trupit dhe dëshirave të tij, prandaj tregohuni të kujdesshëm.

Unë nuk i bëj thirrje askujt që të jetojë në asketizmin Alevit, sepse asketizmi Alevit është më i madh se fjalët dhe mendjet tona. Por, unë bëj thirrje për bindje, që ju të mos lejoni që dëshirat t'ju befasojnë, sepse ato kanë nevojë për kujdes të madh. Dashuria për qetësi, rehati dhe luks janë gjëra që gradualisht lënë ndikime të këqija te njeriu. Ai nuk i realizon ato në fillim të jetës. Nëse një person është i

[50] "Ue imhi an kulubihim khataratel malil fetun", Es Sahijfetu Es Sexhadijeh, duau eth thugur.

interesuar të lëvizë, ai do të zbulojë se nuk është në gjendje dhe, nëse dëshiron të ngjitet, nuk mundet.

Ruani me kujdes mendjen, zemrën, mendimet dhe besimin

Bëni kujdes dhe ruani bashkësinë tuaj. Ruani me kujdes mendjen, zemrën dhe besimin tuaj. Kjo është porosia ime e përhershme për ju. Dijeni se, në rast se e zbatoni këtë porosi, nuk ka asnjë faktor, ose fuqi nën këtë qiell që mund t'ju nënshtrojë. Këto deklarata, grumbullime fuqish dhe kërcënime, të cilat ata i praktikojnë nuk janë argumente që e bëjnë të mundur nënshtrimin e një populli besimtar dhe as mposhtjen e tij, sepse ky popull që zotëron në mesin e tij grupime të fuqishme si ju, nuk mund të mposhtet.

Humbjet, së pari, prekin zemrat

Të gjithë e njohim ndikimin shkatërrues të armëve, por asnjë populli nuk i shkaktohet disfata përmes tyre. Humbjet, së pari, prekin zemrat dhe pastaj munden njerëzit.

Në fillim të luftës, disa prej tyre, për shkak të mungesës dhe mundësive të pakta që kishim, thanë: "Përballë njëqind tankeve duhet të pozicionohen njëqind të tillë, në të kundërt, është e pamundur të futemi në betejë".

Por këta të rinj dhe ata jeni ju, kanë provuar të kundërtën. Për t'i rezistuar dhe për t'iu kundërvënë njëqind tankeve duhen njëqind zemra, njëqind njerëz vetëmohues që nuk mendojnë për veten e tyre. Gjithnjë vërenim që përsëritej që qindra tanke tërhiqeshin para të rinjve trima që mbanin armën RBG, ose një armë të ngjashme me të. Në këtë mënyrë, ata patën sukses të mposhtnin armikun që erdhi i armatosur me pajisje dhe mbështetjen ndërkombëtare. Tani ata filluan ta pranojnë pak nga pak. Ky sukses ishte një akt trimërie dhe besimi, i cili duhet të ruhet mirë. Armiku u detyrua të tërhiqej i mundur, i zhgënjyer dhe i poshtëruar deri pas kufijve. Ky sukses ishte për shkak të trimërisë dhe besimit. Për këtë arsye ai duhet të ruhet mirë.

Ruajeni unitetin tuaj. Një nga synimet që kanë armiqtë dhe pasuesit e tyre, është se ata lakmojnë të shkatërrojnë unitetin brenda gardës. Prandaj ruajeni unitetin dhe harmoninë tuaj. Nëse ka mosmarrëveshje dytësore mbi një çështje të caktuar, duhet t'i lini mënjanë mosmarrëveshjet. Organizoni drejtimin tuaj dhe ecni përpara me gjithë guximin, aftësinë dhe duke u mbështetur te Zoti. Kjo është detyra juaj kryesore. Ruajtja e revolucionit arrihet dhe realizohet përmes kësaj rruge.[51]

[51] Fjala e Imam Khameneit *(Allahu i dhëntë jetë të gjatë!)* me muxhahidinët, më 13.09.2002.

Dallimi midis rindërtimit dhe materializmit

Rindërtimi është puna që bënte Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe vazhdoi ta bënte deri para kalifatit të tij. E ndoshta edhe në periudhën e kalifatit të tij, edhe pse nuk jam shumë i sigurt për të. Por, para kalifatit të tij, kjo është e sigurt. Ai mbillte palma hurme me duart e tij, sistemonte tokën, mbillte pemë, hapte puse dhe vadiste të mbjellat. Ky është rindërtimi. Për sa i përket pasimit të kësaj dynjaje dhe kërkimit të materiales në të, ajo është vepër e Ubejdullah ibn Zijadit dhe Jezidit. Çfarë u ofruan ata njerëzve dhe çfarë bënë ata për ta? Ata vetëm shkatërronin dhe konsumonin. Bënin shpërdorime ekstravagante, duke jetuar në luks. Nga këtu ne mund të bëjmë dallimin ndërmjet këtyre dy koncepteve.

Sot, disa njerëz kanë mbytur veten e tyre, në emër të ndërtimit dhe rindërtimit. Ata janë zhytur në pasuri, në dynja dhe në adhurimin e materiales. Vallë a ka kjo ndopak lidhje me rindërtimin?

Ajo që sot e prish shoqërinë tonë, është zhytja pas kënaqësisë dhe epshit, humbja e shpirtit të devotshmërisë dhe sakrificës, shpirtërores që gjendet te të mobilizuarit.[52]

[52] Një takim me një grup forcash mobilizuese dhe me drejtuesit e brigadave dhe divizioneve, më 13.07.1992.

PËRMBAJTJA

Fjala e Shoqatës.....6
Hyrje.....10
KAPITULLI I PARË - PERIUDHA JONË NDËRMJET ASKETIZMIT DHE UDHËTIMIT NË DYNJA.....13
- Sqarim dhe qartësim.....14
- O Musa, mos rend pas kësaj bote, ashtu siç rendin zullumqarët!.....15
- Mos e duaj këtë botë, ashtu si do nënën dhe babanë.....15
- O Musa, nëse dëshiron të mbështetesh në këtë botë, atëherë dashuria për dynjanë dhe bukurinë e saj ka triumfuar në zemrën tënde.....16
- O Musa, garo me vepërmirët dhe kaloi ata në punë të mira. Mirësia është si emri i saj.....17
- Nga pasuria e kësaj bote, largo atë që nuk të nevojitet.....18
- Mos e shiko atë që të sprovon në këtë botë.....19
- I besoi (iu mbështet) vetes së tij.....19
- Çdo sprovë fillon me dashurinë për dynjanë.....19
- Mos ki zili askënd, për shkak të pasurisë së tij.....20
- Me shtimin e pasurisë, shtohen edhe gjynahet, për shkak të detyrimeve dhe të drejtave.....20
- Mos përkrahni askënd, derisa të dini se Zoti është i kënaqur me të.....20
- Mos e kini zili një person që njerëzit i binden.....20

- Kur njerëzit që i binden atij, e ndjekin atë në rrugën e gabuar, atëherë ajo është humbje dhe shkatërrim, jo vetëm për të, por edhe për ata që e pasojnë atë.....22
- Epoka jonë është periudha e thirrjes në asketizëm.....22
- Udhëheqësi është shembulli dhe modeli për njerëzit në asketizëm.....23
- Më mbështetni me devotshmëri dhe përkushtim.....24
- Largimi nga prirjet aristokratike.....26
- Largimi nga detyra që të është ngarkuar, është tradhti.....27
- Pasojat e gjynaheve.....28
- Fitorja e armikut është rezultat i dhënies pas dynjasë.....29

KAPITULLI I DYTË - RËNIA E NJERËZVE TË VEÇANTË DHE ASKETIZMI I VERBËR.....32
- Sa bujar i mirë është Talha!.....33
- Ebu Musa El Esh'arij dhe dyzet mushkat e tij.....34
- Sa'd ibn Ebi Uekasi dhe plaçkitja e thesarit.....36
- El Uelid ibn Ukbetu, guvernatori i shthurur i Kufes.....38
- Prishja e shpirtrave prodhon njerëz si rabini hebre, Ka'b..41
- Devotshmëria e zyrtarëve i mbron edhe të tjerët.....43
- Të zgjedhësh ndërmjet postit guvernator në Rraj, ose të biesh dëshmor.....45
- Khauarixhët, asketë jo largpamës.....46
- Madhështia e njerëzve të veçantë në adhurim dhe shmangia e gjynaheve.....50
- Asketizmi pa largpamësi, është një lojë në duart e sulltanëve *(udhëheqësve)*.....52

- Fryma e adhurimit, nënshtrim ndaj Allahut të Madhëruar.....54

KAPITULLI I TRETË – IMAM ALIU *(PAQJA QOFTË MBI TË!)*, SHEMBULLI MË I LARTË I ASKETIZMIT.....55
- Asketizmi e zbukuronte Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)*...56
- Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, është maja e asketizmit.....60
- Asketizëm që askush nuk mund t'i rezistojë.....62
- Mielli i ashpër, një mësim për guvernatorin.....67
- Veshja e tij e hollë, në të ftohtin e acartë.....69
- Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ishte njeriu më prodhues dhe më asket.....70

KAPITULLI I KATËRT - ASKETIZMI ËSHTË KULTURË DHE KURË SHËRUESE.....73
- Lum ata që janë gjithmonë në namaz!.....74
- Çfarë nënkupton një jetë e mirë dhe e këndshme?.....75
- Asketizmi, çështja më e madhe që është trajtuar në veprën "Nehxhul Balaga".....76
- Gradat e asketizmit, në të lejuarën (hallall) dhe të ndaluarën (haram).....77
- Transformimi i asketizmit në kulturë.....78
- Asketizmi, dera e lartësimit shpirtëror.....79

KAPITULLI I PESTË - NJË FJALË PËR BURRAT QË I KANË ZEMRAT E LIDHURA ME ZOTIN DHE QËNDROJNË TË PALËKUNDUR NË RRUGËN E TIJ....83

Ju dhe familjet tuaja të pastra jeni model dhe shembull.....84
- Armiku punon për të shkatërruar strukturën islame.....85
- Shpërbërje kulturore, kjo është sfida.....86
- Dashuria për dynjanë dëmton historinë e Islamit.....87
- Mos u përzieni me përfitime dhe interesa personale.....89
- Ajo që ka vlerë në këtë çështje.....90
- Kujdesuni për zemrat tuaja dhe për zemrat e atyre që janë me ju.....92
- Një jetë e qetë dhe me luks krijon dyshime.....93
- Ruani me kujdes mendjen, zemrën, mendimet dhe besimin.....94
- Humbjet, së pari, prekin zemrat.....94
- Dallimi midis rindërtimit dhe materializmit.....96
Përmbajtja.....97

مفتاح الخير

آية الله العظمى السيد على الخامنئى (دام ظله الشريف)

تيرانا 2021

اسم الكتاب: **مفتاح الخير**

المؤلف: **آية الله العظمى السيد على الخامنئى** (دام ظله الشريف)

المترجم: **الحاج ولنت مريا**

التصحيح الأدبي: **يريدا كولا**

التصحيح اللغوي: **ويولسا كاراي**

الاخراج النهائي و تصميم الغلاف: **صبريه فزا**

ناشر: **جمعية النسيم – تيرانا – ألبانيا**